

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULLTETI JURIDIK
ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME POSTDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

INSTITUTI I FALJES DHE NDRYSHIMET PËRKATËSE LIGJORE- RASTI
IVANOV-ANALIZË KRAHASIMORE

KANDIDATI:

Vetim Rustemi

MENTORI:

Prof. Dr. Besa Arifi

Tetovë, 2019

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
KAPITULLI I	4
KAPITULLI I	4
1.PJESA HIPOTETIKE E PUNIMIT.....	4
1.1.QËLLIMI I STUDIMIT	4
1.2.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	6
1.3.HIPOTEZAT KRYESORE.....	7
KAPITULLI II	8
2.VËSHTRIMI HISTORIK I INSTITUTIT TË FALJES	8
2.1. PERIODIZIMI I HISTORISË SË INSTITUTIT TË FALJES	8
2.2. ASPEKTET HISTORIKE TË DREJTËS SË FALJES QË RRJEDHIN NGA PERANDORIA OSMANE.....	11
KAPITULLI III	22
3.TRAJTIMI JURIDIKO PENAL I INSTITUTIT TË FALJES.....	22
3.1.NOCIONI DHE KUPTIMI I INSTITUTIT TË FALJES	22
3.2. FALJA	24
3.3. AMNISTIA	33
3.4. DALLIMET NË MES FALJES, AMNISTISË DHE ABOLACIONIT	41
KAPITULLI IV.....	44
4.RASTI I AKTIT TË FALJES NGA ANA E PRESIDENTIT TË RM-SË NË VITIN 2016	44
4.1. LIGJI PËR FALJE DHE NDRYSHIMET PËRKATËSE LIGJORE	44
4.2. MARRJA E VENDIMIT PËR FALJE.....	46
4.3. ANULIMI I PJESSHËM DHE TËRHEQJA E VENDIMIT TË FALJES	53
4.4. INTERVISTA.....	57
KAPITULLI V	61
5. KONKUZIONE DHE PËRFUNDIME.....	61
BIBLIOGRAFIA.....	63
KUSHTETUTA DHE LIGJET	65
WEB FAQET E KLIKUARA	65

HYRJE

Në Maqedoni që nga pamvarsimi I saj e drejta e faljes dhe amnistia kanë qenë gjithmonë temë diskutimi rreth faktit të zbatimit në praktik të saj, dyshimet për shfrytëzimin e kësaj të drejte në mënyrë selektive dhe për interesa të ngushta të individëve të caktuar dita ditës janë shtuar dhe janë bërë sa ma aktuale, gjithashtu duke u nisur nga fakti i mungesës së një analize krahasimore në lidhje me institutin e faljes si dhe aktualiteti i rastit të kryetarit të shtetit në lidhje me zbatimin praktik të tij ishin arsye kryesore që më shtynë t'i qasem analizës dhe shqyrtimit të kësaj teme e cila në vete ngërthen një insitut të së drejtës penale që ka të bëjë me faljen e personave të dënuar dhe posaçërisht rasis I kryetërit të shtetit I cili kërkon një shyrtime të detajuar.

Në këtë punim do të mundohem që duke I shfrytëzuar metodat e caktuara të arij që tema në vete të ngërthejë një analizë krahasimore të institutit të faljes dhe ecurisë së zhvillimit të saj që nga kohërat më të lashta deri në rregullimin juridik të saj në ditën e sodit, gjithashu tema do të përfshij krahasimin e zbatimit të këtij insitutit në veçanti në periudhën e Perandorisë Osmane me formë të rregullimit juridik të sheriatit si dhe në pjesën e fundit do të analizohet rrjedha e veprimeve të Presidnetit të shtetit deri në vendimin final të tij, duke analizuar dhe shqyrtuar efektet dhe pasojat juridike të këtyre veprimeve.

KAPITULLI I

1.PJESA HIPOTETIKE E PUNIMIT

1.1.QËLLIMI I STUDIMIT

Shteti dhe e drejta, janë produkte dhe premisa të zhvillimit të shoqërisë që prej kohëve më të lashta. Në lashtësi si shteti ashtu dhe e drejta kanë qenë të pazhvilluara, siç kanë qenë të pazhvilluara marrëdhëniet midis njerëzve në këtë shoqëri, me kalimin e kohës marrëdhëniet zgjërohen dhe bëhen shumë më të larmishme. Si rezultat, zgjërohet dhe zhvillohet makina shtetërore dhe bashkë me të dhe e drejta, duke përfshirë fusha gjithnjë e më të gjëra të veprimtarisë së shoqërisë. Influenca globale të ditëve të sotme, lidhur me krizat ekonomiko-shoqërore, të cilat sot godasin edhe vendet tona, sjellin vështirësi mjaft të mëdha për familje të tëra në mbarë botën, duke shfaqur fenomenin e “luftës për egzistencë”. Kjo problematikë paraqet virus apo epidemi botërore që godet njerëzimin në të gjitha sferat e civilizimit, e cila sjell si rezultat një rritje kuantitative të kriminalitetit ku me rritjen e kriminalitetit vjen deri te mundësia e aplikimit të një instituti të së drejtës penale dhe atë institutin e faljes. Instituti i faljes është një institut mjaft kompleks i cili është një element i vjetër i sistemit të drejtësisë e posaqërisht të së drejtës penale. E njëjta vazhdon të jetë aktuale edhe në ditët e sotme. **Sipas Kodit Penal të RM-së Falja paraqet një pushtet të jashtëzakonshëm ekzekutiv të Presidentit për t’i falur personat e dënuar për krime, duke i liruar plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi i dënimit përfundimtar të gjykatës.** Kodi Penal i RM-së bën dallim në mes të faljes dhe amnistisë ,falja dhe amnistia do të trajtohen me të gjitha specifikat dhe karakteristikat e tyre si nga menyra e zbatimit, rrethanat në të cilat mund të zbatohet, veprat penale ndaj të cilave mund të zbatohet, personat ndaj të cilëve mund të zbatohet, si dhe organi shtetërorë që mund të zbatojë këtë institut. Duke marrë parasysh fenomenin e institutit të faljes e cila shfaqet shumë shpesh, përfshirë edhe shtetin tonë dhe mbarë botën moderne më motivoi që të përcaktohem në analizën e kësaj teme. Ky material ka për qëllim të analizojë një nga kompetencat kushtetuese më interesante të Kryetarit të shtetit , të drejtën për të dhënë falje. Kjo

e drejtë është zhvilluar gjatë gjithë historisë dhe është shfaqur në shumë forma, ajo ka evoluar në një të drejtë të rregulluar kushtetuese dhe ligjore, e cila përbëhet nga një institut i rëndësishëm i së drejtës penale dhe penologjisë pasi falja e presidentit zakonisht ka pasoja serioze që kanë të bëjnë me ligjin penal, procedurën penale dhe ekzekutimin e sanksioneve. Punimi do të analizojë kontekstin historik të së drejtës për falje, me këtë synojmë të shpjegojmë lidhjen e kësaj të drejtë me fuqinë absolute të monarkëve në të kaluarën, gjithashtu do të diskutohet në mënyrë më të detajuar konteksti I së drejtës për falje dhe përdorimin në praktikë të sajë në Perandorinë Osmane duke krahasuar atë me përdorimin e kësaj të drejte në kohën modern, për më tepër punimi do të diskutojë zhvillimet e fundit në lidhje me të drejtën për falje në Republikën e Maqedonisë, ku Viti 2016 ka dëshmuar dy ndryshime të mëdha në legjislacionin e këtij vendi në lidhje me të drejtën për të falur që I mundësoji Presidentit të shtetit që së pari të nxjerrë 41 falje kontradiktore, duke bërë më vonë tërheqjen e pjeshme të tyre dhe më pas t'i tërheq tërësisht ata që ka treguar të jetë një nga skandalet më të mëdha ligjore të këtij shteti në historinë e saj të shkurtër të pavarësisë. Punimi do të analizojë pasojat e faljes së Presidentit të dhënë dhe pastaj të tërhequr duke analizuar metodologjinë dhe arsyetimin ligjor të këtij akti, mendimet dhe vlerësime e profesorëve univerzitar si dhe ekspertëve të ndryshëm lidhur me vendimet e presidentit.

Pas përfundimit të pjesës historike dhe teorike të punimit janë realizuar edhe intervista me zyrtarë institucional të përfshirë në zbatimin e institutit të faljes. Intervistë është realizuar me Ministrin e Drejtësisë. Gjithashtu janë realizuar edhe takime me diskutime interaktive për të kuptuar thelbin e këtij instituti dhe vetë veprimin e presidentit të shtetit për të analizuar mendime të ndryshme lidhur me çështjet më thelbësore që kanë të bëjnë me institutin e faljes dhe atë me zyrtarë të Presidencës, zyrtarë të Ministrisë së drejtësisë, gjykatës, zyrtarë të institucionit të Avokatit të Popullit, përfaqësues dhe zyrtarë të organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut dhe juristë.

Punimi do të ofrojë konkluzione dhe rekomandime në lidhje me temën.

1.2.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Gjatë studimeve shkencore për t'u arritur qëllimi i caktuar, shkenca përdor metoda të cilat thjeshtë paraqesin veprimet subjektive të hulumtuesit lidhur me objektin e caktuar. Metoda është e lidhur ngushtë me objektin e studimit ku shkenca për ta arritur qëllimin e caktuar që më herët kërkon rrugë, mënyra, mjete se si të përfundojë më së miri ky proces, andaj kuptohet se metoda paraqet tërësinë e veprimeve mendore dhe fizike në procesin e njohjes së qëllimit të caktuar.

Për hulumtimin, kërkimin dhe studimin e rasteve lidhur me këtë punim do të shfrytëzohen këto metoda:

Metoda normative – me anë të kësaj metode arimë të marim njohuritë thelbësore për kuptimin e mirfilltë të tezës së studimit duke u bazuar në rregullimin normativ të çështjes kryesorë të studimit konkretisht në rregullim normative të institutit të faljes si dhe të amnistisë , duke shqyrtuar rregullimin ligjorë dhe kushtetues të tyre, pra me anë të kësaj metode analizohet e drejta si sistem i tërësishëm normative dhe i marim njohurit për pjesën më të madhe të së drejtës.

Metoda Krahasuese – Do të shfrytëzohet për krahasimin e emërtimit ligjor të institutit të faljes së personave të dënuar dhe të atyre që gjenden në zhvillim të procedurës penale dhe efektin e zbatimit të institutit të faljes në RM, me kodet penale, ligjet të mëparshme dhe ato aktuale, si dhe krahasimin me legjilsacionet tjera edhe atë me kodin penal të Kosovës, Shqipërisë etj. Posaçërisht metoda krahasuese do të shfrytëzohet për të bërë krahasimin thelbësorë të zbatimit të institutit të faljes në periudhën e hershme nga ana e monarkëve dhe rregullimit të saj në sistemin e drejtësisë, si dhe krahasimi i zbatimit në praktikë të këtij instituti në periudhën e sundimit të Perandorisë Osmane nga ana e Sulltanëve dhe zbatimi i këtij instituti në kohën moderne.

Metoda e Anketimit dhe Intervistës – Kjo metodë do të shfrytëzohet për anketim dhe intervistë të personave ndaj të cilëve është zbatuar instituti i faljes , lidhur me pasojat e tyre pas kryerjes së veprës penale, gjatë vuajtjes së dënimit dhe posaçërisht pas marrjes së vendimit dhe zbatimit të institutit të faljes. Kjo metodë do të shërbejë edhe për intervistën e përfaqësuesve ligjorë, rëspektivisht bartësve të pushtetit për të kuptuar rrjedhën e veprimeve të ndodhura në

RM në periudhën e vitit 2016 për të kuptuar nga afër zhvillimin e gjithë ati procesi që nga ndryshimet kushtetuese, faljet e dhëna , tërheqja e pjeshme se dhe tërheqja e plotë e tyre. Me anë të anketimit dhe intervistës do të merren mendimet e juristëve dhe profesorëve universitar në lidhje me kuptimin, zbatimin e këtij instituti e posaqërisht me veprimet e Presidentit të shtetit.

Metoda analitke – Kjo metodë do të shfrytëzohet lidhur me analizën e manifestimit të institutit të Faljes, analizën e statistikave të përfituara nga hulumtimet paraprake, analizën e formave më të përfaqësuara të institutit të faljes në Republikën e Maqedonisë. Në këtë metodë do të bashkangjiten edhe **metoda e observimit apo vrojtimit** me të cilën do të qartësohen vetitë, cilësitë dhe sjelljet si para ashtu edhe pas zbatimit të këtij instituti të së drejtës penale.

1.3.HIPOTEZAT KRYESORE

- 1.Perandoria Osmane si model për kuptimin e zbatimit të institutit të faljes në periudhën e hershme (historiku I zbatimit të këtij instiutit);
- 2.Ekzistojnë dallime thelbësore midis konceptit modern të faljes dhe faljeve të dhëna në shekujt e mëparshëm në lidhje me arsyet për të cilat ato janë dhënë(krahasimi teorik dhe praktik);
- 3.Efekti i zbatimit të institutit të faljes dhe trajtimi i personave pas zbatimit të këtij instituti;
- 4.Arsye për zbatimin e faljes dhe amnistisë;
- 5.Aspekti historik në të drejtën për falje në kontekstin e ndëshkimit të korrupsionit të zyrtarëve shtetërorë;
- 6.Falja e dhënë nga Presidenti Ivanov mund të konsiderohet si një keqpërdorim serioz I kompetencës presidenciale për falje për të mbrojtur politikanët e korruptuar.

KAPITULLI II

2.VËSHTRIMI HISTORIK I INSTITUTIT TË FALJES

2.1. PERIODIZIMI I HISTORISË SË INSTITUTIT TË FALJES

Metoda historike e studimit të tendencave themelore në zhvillimin e së drejtës penale dhe menidmit shkencorë është e nevojshme për të zbuluar distancën e mendimeve bashkëkohore nga idetë dhe shikimet për të cilat mendojmë se I takojnë të së kaluarës. Që në kohërat më të lashta prej paraqitjes së të drejtës penale shteti e ka mbajtur të drejtën e faljes për kryerësin e veprës penale të shprehur nëpërmjet autiroizimit që ndonjëherë kundër tij të mos ngritet ndjekje penale ose personit të dënuar ti zbutet ose ti falet dënimi. Bazat filozofiko-juridike të institutit të faljes (amnisitia dhe falja) I tejkalojnë sqarimet të cilat mundohen të gjenden për të dhe ngjasojnë me arsyetimin racional plotësues kriminalo-politik.¹ Vështruar nga aspekti historik, instituti I faljes sikurse edhe institutite e tjera të së drejtës, degët e së drejtës dhe e drejta në përgjithësi kalon dhe formësohet në periudha të ndryshme kohore historike konformë kushteve dhe marrëdhënieve shoqërore të periudhave të ndryshme. Shiqvar nga aspekti historik institute I faljes buron nga falja e personave të dënuar për veprat e dënueshme të kryera nga ato. Që nga kohërat më të lashta, prej paraqitjes të shtetit dhe së drejtës (të drejtës penale) shteti e ka rezervuar të drejtën e faljes për kryerësit e veprave penale e shprehur nëpërmjet autorizimit me qëllim që kryerësi i veprës të mos ndiqet penalisht ose personit të dënuar ti zbutet dënimi ose të falet.

Vështruar nga aspekti historik të drejtën e faljes mundë ta periodizojmë në disa periudha kohore dhe atë :

- Periudha parahistorike (historija e kohës së vjetër)
- Periudha e skllavopronaro- feudale (historija e kohës së mesme)
- Periudha liberale dhe bashkëkohore (historija e kohës së re)

¹ KAMBOVSKI Vllado “ Edrejta penale pjesa e përgjithshme”;(përkthim në gj.shqipe Afrim OSMANI dhe Ismail ZEJNELI) fq.630

Në periudhen parahistorike (historija e kohës së vjetër) e drejta e faljes në paraqitjen e saj të parë mund të vërehet që nga koha e antikitetit kur njerëzit ishin të organizuar në klane dhe fise dhe kjo lejon të kuptojmë se kur personi i një klani ose fisi nuk i përmbahej rregullave të caktuara nga ana e vet klanit ose fisit ai përjashtohej nga shoqëria dhe pas një periudhe i njejtë ka mundur të falej e të kthehet përsëri në atë klan ose fis, mirëpo kjo paraqitje historike e faljes haset më tepër si çështje e faljes morale e jo e faljes në bazë të së drejtës pasi që në atë kohë nuk ka ekzistuar e drejta në përgjithësi e as edhe falja si formë e rregulluar në aspektin juridik.

Periudhë tejteer nëpërmjet së cilës mundë ta kuptojmë kalimin e institutit të faljes është koha e hapave të para të rregullimit juridik të shtetit dhe së drejtës me anë të monarkëve ose mbretërve të cilët kanë përfaqësuar sovranitetin e shtetit ku e drejta e faljes ishte e drejtë e rezervuar (privilegj) posaqërisht e monarkut ose e mbretit, i cili vet vendoste se cilët persona ka dashur ti falë, të zbus dënimin apo t'i lirojë nga denimi.

E drejta në këtë periudhë është bazuar kryesisht në të drejtën zakonore, më vonë në të drejtën romake, ndërsa në pjesën e fundit të kësaj periudhe e drejta është bazuar edhe në të drejtën hynore si pjesë e të drejtës së përgjithshme në feudalizëm, ku e drejta në këtë periudhë kishte karakter të hapët klasor, sepse shprehte pabarazinë formale juridike ndërmjet personave që u takonin klasave dhe shtresave të ndryshme shoqërore, kjo shprehej më së shumti në sferën e së drejtës penale.² Jo barazia formalo-juridike në të drejtën penale vërehej në rastë se kryhej një delikt i njejtë nga persona të cilët u përkasin shtresave të ndryshme shoqërore dënimet ishin të ndryshme. Shoqëria në këtë periudhë është polarizuar në skllavopronar/feudal dhe në skllav/bujkërobër ku skllavi ose bujkërobi ishin pronë e skllavopronarit apo feudalit dhe për veprat e kryera ose për mosdëgjueshmëri skllavi dënohesj por, edhe mund të falej nga pronari i vet (skllavopronari ose feudali), për vepra të kryera kundër shtetit ose interesave të monarkut është vendosur nga vet monarku për dënimin ose faljen e tij edhe pse mund të thuhet se ka pasur raste të rralla apo aspak kur një skllavopronar apo bujkërob është falur për veprën e kryer në këtë periudhë sepse për veprat penale të kryera kundër shtetit dhe për veprat penale kundër personit (vrasje) parashihej denimi me vdekje, ndërsa për veprat e tjera penale si psh. veprat

² Hilmi Ismaili & Fatmir Sejdiu "HISTORIA E INSTITUCIONEVE JURIDIKE DHE SHTETËRORE" Prishtinë, 2009 fq.51

kundër pasurisë dënoheshin me rrahje dhe kompezim të dyfishtë të sendit të vjedhur ose të dëmtuar³.

Periudha liberale bashkëkohore, karakterizohet me shprehjen e institucioneve juridike dhe shtetërore të ndërtuara mbi parimet e lirisë dhe barazisë së njerëzve para ligjit, të lirive qytetare dhe politike, të sovranitetit shtetërorë , të kushtetutshmërisë, të parlamentarizmit, të disponimit të lirë të pronës etj.⁴ Kjo periudhë është bazuar kryesisht në parimin e kushtetutshmërisë, parimin e ligjshmërisë, parimi i sovranitetit, parimi i ndarjes së pushtetit, parimi i barazisë para ligjit, është po kjo periudhë e lindjes së maksimës së njohur: Nullum crimen sine lege- nullum poena sine lege (Nuk ka krim i cili nuk është i parashikuar me ligj dhe nuk ka sanksion i cili nuk është i parashikuar me ligj). Kjo është periudha kur fillon të bëhet ndarja e pushtetit të një shteti dhe atë parashihen tri pushtete brenda shtetit: pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor.

E drejta në këtë periudhë duhet theksuar se në krahasim me të drejtën e më hershme feudale është e një niveli jashtëzakonisht më e zhvilluar, ajo si e tillë do të jetë në të gjitha degët e së drejtës dhe si rezultat i zhvillimit të marrëdhënieve të përgjithshme shoqërore dhe ekonomike do të lindin edhe disiplina të posaçme juridike me të cilat do të rregullohen lëmi konkrete si dhe do të paraqiten institute të ndryshme në kuadër të së drejtës ndër to edhe institui i faljes si institut i vaçant në kuadër të së drejtës penale.⁵ Duke u bazuar në parimet karakteristike të kësaj periudhe duhet të ceket se e drejta në përgjithësi ka pësuar një hov të jashtëzakonshëm të zhvillimit duke i rregulluar shumë çështje konkrete në kuadër të së drejtës me ligje të posaçme dhe me akte të tjera nënligjore, të njejtin fat e ka pësuar edhe e drejta e faljes apo intituti i faljes ku për zbatimin e të njejtës lind nevoja e nxjerrjes së ligjit të posaçëm me të cilën do të rregullohen shumë çështje në kuadër të kësaj të drejte. Sot vlerësohet se amnistia dhe falja kanë rëndësi të instrumenteve të veçanta të shfrytëzuara për zgjedhjen e situatave dhe rasteve të llojllojshme që mund të ndeshen pas plotfuqishmërisë së vendimit.

³ Hilmi Ismaili & Fatmir Sejdiu "HISTORIA E INSTITUCIONEVE JURIDIKE DHE SHTETËRORE" Prishtinë, 2009 fq.145

⁴ Po aty fq.231

⁵ Po aty fq.245

2.2. ASPEKTET HISTORIKE TË DREJTËS SË FALJES QË RRJEDHIN NGA PERANDORIA OSMANE

Perandoria Osmani si një fuqi e epokës së mesme evropiane si dhe monarkitë e tjera të asaj kohe njiheshin me një karakterisitikë praktike e cila ishte shumë e dalluar pasi sundimtari suprem i asaj monarrike konsiderohej si personi më i rëndësishëm që pritej të kujdeset për mirëqenijen e popullit të tij. Perandorinë Osmane nga monariktë tjera të asaj kohe e bën të dallohet me faktin e ashpërsisë së administratës së qeverisë, kjo ka të bëjë me administrimin e drejtësisë. Vetë administrimi i drejtësisë shpije në atë se Sulltani për dallim nga monarkët e asaj kohe ai konsiderohej si sundues absolut për mbajtjen e drejtësisë mes popullit të tij pasi ai në bazë të literaturës së kohës llogaritej si Kalif⁶ i muslimanëve , të njohur si “Hija e Zotit në tokë, i cili çdo person strehon , ku konsiderohej si kujdestarë të vendit të Perëndisë kundër shtypjes dhe tiranisë si dhe shpërndarës së drejtësisë”. Kjo shpjegohet nga ana e autorit Uriel Heyd në librin “Studime në të drejtën e vjetër penale Otomane“ ku thuhet :

“Si zëvendëskryesuesi I *All-llahut* në këtë botë, Sulltani nuk konsiderohej si një autokrat i tiranisë, por si një fuqi e largët supreme që dënoi organet ekzekutive të qeverisë së tij për veprimet e tyre shtypëse kundër popullit. Jo vetëm që njerëzit e zakonshëm ishin vendosur nga Perëndia në ruajtjen e tij. Populli ishte themeli I Shtetit dhe do të humbiste nëse do të ishte i privuar nga drejtësia (ëa-la ra’iya illa bi’l-’adl)”. Duke marrë parasyshë faktin se Perandoria Osmane ishte një monarki absolute, do të kuptohet se Sulltani si sundues suprem dhe administrator i drejtësisë mund të ndëshkojë ose të falë cilindo sipas vullnetit të tij, megjithatë formalisht kjo nuk ishte e mundur, pasi Sulltani duke mbajtur titullin e Kalifit ishte i detyruar të sundonte në përputhje me Ligjin e Sheriatit, pra ligji penal i sheriatit ishte burim kryesorë i ligjit ne Perandorinë Osmane që do të thotë se ishte pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm ligjor të perandorisë, duke përfshirë ndarjen strikte të krimeve në tre kategori: *hudud*, *qesas* dhe *ta’azir*. Bassiouni thekson se:”krimet **hudud** janë të dënueshme nga një had, që nënkupton se dënimi për ta është i themeluar dhe është i paraparë në përputhje me “të drejtën e Perëndisë”

⁶ Fjala **hilafet** ose **kalifat** rrjedh nga ajo arabe *khalīfa*. **Kalifi** quhet në **arabisht** خليفة رسول الله *Ḥalīfa*, shumë *Ḥulafā'* (pasardhës në post, mëkëmbës, kalif) ose *khalīfat allāh* ose *khalīfat rasūl allāh* që do të thotë e përkthyer fjalë për fjalë „mëkëmbës i Zotit“ ose „pasardhës i të dërguarit të Zotit“. Kalifati paraqet formën e **regjimit islamik**, në të cilën udhëheqja shekullare (*laīke*) dhe fetare është vetëm në dorën e kalifit.

dhe është përshkruar nga Kurani ose nga Suneti, ndjekja penale dhe ndëshkimi për krime të tilla janë të detyrueshme në krahasim me veprat penale të ta'azirit ndjekja e të cilëve është diskrecionale, kurse **qesas** janë një kategori e krimeve që kombinojnë atë që ligji i zakonshëm i konsideron krime kundër personit dhe krime të kategorisë së ngjajshme. Kësaj kategorie të krimeve nuk i është dhënë një përkufizim specifik dhe i detyrueshëm kriminal ose dënim i paraparë në Kuran dhe ndëshkimet për këtë kategori të krimeve fillojnë me të ashtuquajturën “ligji i shtresës” dhe kategoria e marur nga Kurani për këtë grup është kompezimi i viktimës. Pasi ligji i Sheriatit ka qenë kryesisht i pa sistematizuar, juristët osman krijuan kodifikime të ndryshme të njohura si kanunname që kodifikonin degë të ndryshme të ligjit. Akif Aydın shpjegon këtë proces interesant në librin e tij "Türk Hukuk Tarihi" duke theksuar se shumica e kodifikimeve përfshinë dispozitat e ligjit penal në mënyrë që të arrihet krijimi i një mjeti më gjithëpërfshirës dhe më të dobishëm për administrimin e drejtësisë⁷. Kategoria e krimeve dhe dënimeve **ta'azir** nuk rregullohet drejtpërsëdrejti në Kur'an dhe në Sunnet, në vend të kësaj, lihet në diskrecionin e gjyqtarit që të zbatohet sipas shkollave të interpretimit. Bassiouni thekson se : “veprat e ta'azirit janë ato që nuk janë të përfshira në asnjë nga dy kategoritë e mësipërme ,ato përbëjnë sjellje që sjellin dëm individual ose social të prekshëm apo të pa prekshëm dhe për të cilat qëllimi i dënimit duhet të jetë korrektues dhe kjo është pikërisht kuptimi i fjalës ta'azir”. Aydın shpjegon se në ligjin penal osman, në vend të dhënies së një pavarësie dhe kompetence aq të gjerë për gjyqtarët, opsioni që mbizotëronte ishte rregullimi i krimeve dhe dënimeve të ta'azirit në kanunname, pra në ligjin e kodifikuar me kusht që krimet hudud dhe qesas të rregullohen rreptësisht nga ligji i Sheriatit dhe gjyqtari është i detyruar rreptësisht nga kjo rregullore, krimet ta'azir ishin kategoria që u shfaqën më së shumti në kanunname të ndryshme dhe mbuluan një gamë të gjerë të veprave dhe dënimeve, kështu gjyqtarët (kadıs) ishin të detyruar të ndiqnin jurisprudencën ligjore islame (Fikh), duke vendosur në rastet e had dhe qesas, pastaj përsëri kodifikimi ligjor (kannunames) duke vendosur në rastet ta'azir⁸.

Në këtë drejtim, kanunames përdorën kodifikimin ta'azir për tre qëllime kryesore:

- Përcaktimi i veprave penale dhe gjobave që nuk mbulohen nga had dhe qesas;

⁷Besa Arifi "The Head Of State's Right to Pardon – In History And Today" II Turk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri, v.2016, fq.558

⁸ Akif Aydın "Türk Hukuk Tarihi" Istanbul 2013, fq.217,218

- Vendorsja e dënimeve shtesë për ta'azir për rastet kur krimet e hududit ose të qesas nuk mund të vërtetoheshin absolutisht në pajtim me standardet strikte të provave për këto krime, prandaj dënimet e kishte apo qesas nuk mund të ekzekutoheshin;

- Për të rregulluar dënimet e rënda ose qesas për raste më pak serioze (dmth., Kanunames parashikonin p.sh. përmbajtjen dhe vlerën e të vjedhurit që duhet të arrihet si standard për ekzekutimin e dënimit të amputimit të duarve për krimin e vjedhjes Sariqa, prandaj, në rast të shkeljeve të vogla të vjedhjes, në vend të amputimit, vjedhësi do të dënohet me gjobë.)⁹.

Shumica e dijetarëve pajtohen se dallimi midis krimeve të përcaktuara më lartë është bërë në përputhje me ndarjen e të ashtuquajturve vlera hynore dhe atyre njerzore ose humane, duke marrë parasyshë që krimet hudud përmenden drejtpërdrejtë në Ku'ran dhe Sunnet edhe pse nganjëherë ata janë të lidhura me të drejtën personale , krimet e qesas llogariten si krime që sulmojnë ose cënojnë të drejtën personale/humane, ndërsa nga ana tjetër krimet e ta'azir me patjetër të rregullohen me statut dhe të paraqesin një dispozitë të hapur kur krimet e reja korrespondojnë me zhvillimet e ardhëshme dhe shihen në sistemin penal të Sheriatit.

Në këtë drejtim, ligji osman dëshmoi një kombinim interesant të traditës ligjore kontinentale evropiane, të së drejtës ligjore të evidentuar nga romakët dhe më gjerë, me ashpërsinë dhe rreptësinë e ligjit të Sheriatit që rrjedh nga Lindja, i cili i dha pak mundësi për të shmangur dënimin dhe për të ikur me krime. Ky perceptim i ligjit dhe zbatimi i tij pasqyrohet edhe në konceptin e krimeve siyasah dhe përgjegjësisë që erdhi me pozitën e çdo zyrtari shtetëror që i nënshtrohet sunduesit.

Lidhur me të drejtën për falje në lidhje me Ligjin islam të Sheriatit, I cili ishte burim kryesor i Perandorisë Osmane ngërthen disa çështje të cilat duhet të analizuar dhe të shpjegohen edhe atë:
1.çfarë konsiderohet një falje për një krim? **2.**A mund të falen të gjitha krimet apo jo? **3.**Kush ka të drejtë të japë një falje?

⁹ Besa Arifi "The Head Of State's Riht to Pardon – In History And Today" II Turk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri, fq.558

2.2.1. NOCIONI I FALJES NË LIGJIN E SHERIATIT DHE ZBATIMI I TIJ NË PERANDORINË OSMANE

Duke pasur parasysh që burimi i së drejtës ne Perandorine Osmane ka qenë Ligji i Sheriatit, duhet që të paraqitet kuptimi i të drejtës së faljes i përcaktuar në bazë të së drejtës së sheriatit. Kështu që falja në rradhë të parë është e përcaktuar në vetë Kuranin , ku All-llahu shprehet nëpërmjet ajeteve për vetë rëndësië e faljes. Komentuesit e Ku’ranit faljen nga ana e Zotit e ndajnë në dy grupe edhe atë¹⁰ : E para, mëshira apo falja që vjenë nga ana e Zoit si mirësi apo favor kurse njeriu nuk bën ndonjë përpjekje për ta fituar atë, argument për këtë është ajeti kuranorë ku All-llahu thotë: *mëshira Ime kaplon çdo gjë.(Kurani 7:157)*. Të gjithë njerëzit pa dallim përfitojnë nga kjo mëshirë e Zotit pa bërë asnjë vepër të veçantë. E dyta, kur falja dhe mëshira e Zotit vjen si rrjedhojë e asaj kur njeriu në rradhë të parë e ka shkelur ligjin e Zotit dhe për të njejtën kërkon falje nga Ai, sepse Zoti i falë edhe gabimtarët edhe pse Ai zemërohet për të njejtën, kjo theksohet në një hadith të Dërguarit të Zotit, në përmbledhjen të Buhariut dhe Muslimi me të cilën tregon se mëshira e Zotit e tejkalon edhe hidhërimin e tij edhe atë : “Mëshira Ime tejkaon hidhërimin tim”

Autori Yasar Yigit në librin e tij “Islam ceza Hukuku – Hukumlerinin Yurulugu “ shpjegon kuptimin e fjalës falje (“afa” në arabishte dhe “af” ose “afv” në turqisht) duke treguar konotacionin e tij për faljen e një personi që ka bërë padrejtësi, kurse autori Mustafa Avçi, në librin e tij “ Turk hukuk tarih Dersleri” shpjegon gjithashtu se falja do të thotë të falësh dënimin e vendosur ose të heqësh plotësisht akuzën, për më tepër ai citon Ku’ranin edhe atë : “Pendimi i pranuar nga All-llahu është vetëm për ata që bëjnë keq (inJORANCË ose pakujdesi) dhe pastaj pendohen shpejt.Të tillëve All-llahu do t’i fale , All-llahu është i gjithëdijshtëm dhe i mençur. Por pendimi nuk pranohet nga ata që vazhdojnë të bëjnë vepra të këqija derisa kur të vijë vdekja tek njëri prej tyre, ai thotë: “në të vërtetë tani pendohem”, ose të atyre që vdesin kur janë jobesimtarë. Për ata Ne kemi përgaditur një dënim të dhembshëm.”¹¹

Meqenëse e drejta e Sheriatit bazohet në burime të ligjshme fetare siç është Kur’ani dhe Sunneti, është e kuptueshme që koncepti i faljes merr pjesë në një varg ajetesh të librit të ajetit si

¹⁰ <https://www.ahmadiyya-islam.org/al/fjalimet-e-xhumave/2015/07/10/2015-07-10/>

¹¹ Besa Arifi “The Head Of State’s Riht to Pardon – In History And Today” II Turk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri, fq.559

dhe në shumë hadithe, siç thekson autori Yasar Yigit se duhet të merret në konsideratë se ndonëse falja është e lartë në shumë raste në Kur'an dhe karakterizohet edhe si tipar i veçantë i Zotit (i cili përshkruhet si më i mëshirshëm) , është gjithashtë në Kur'an se “rëndësia e dënimit të drejtë, të drejtë dhe të pashmangshëm të krimeve është e nevojshme”, ai gjithashtu thekson se sipas Kur'anit veprat e kryera pa dëshirë janë ato që falen ,ndërsa përkushtimi i vazhdueshëm dhe i gatshëm i krimieve në recidivizëm nuk është i falshëm në asnjë mënyrë, në këtë drejtim të gjithë studiuesit e të drejtës së sheriatit nënvizojnë njëzëri se falja e një krimi të dënueshëm siasp Ligjit të Sheriatit i cili sulmon dhe cënon të drejtat personale të viktimës është thjeshtë i pamundur pa pëlqimin e viktimës apo trashëgimtarëve të tij.¹²

Për sa i përket faljes së kategorive të veçanta të krimeve, ekziston dallim I qartë nëse ato mund të falen dhe në çfarë mënyre. Është padyshim e vërtetuar dhe siç është shpjeguar edhe më lartë se krimet hudud nuk mund të falen në asnjë mënyrë, përjashtimet e vetme të kësaj rregulle janë krimet e vjedhjes (Sariqa) dhe shpifjes(Kadif). Sa i përket këtyre dy krimeve të hududit, nëse viktimë e vjedhjes ose viktimë e shpifjes ua falë kryerësit të veprës duke mos ngritur akuzë kundër tij, atëherë nuk do të ekzekutohet dënimi pasi që edhe pse përfaqësojnë krime kundër të ashtuquajturës të drejtave të Perëndisë ato gjithashtu përfshijnë të drejtat personale si e drejta për pronë dhe e drejta për dinjitet, pra në këtë rastë akuza e viktimës është vendimtare për dënim.¹³ Shkollat islamike kanë mendime të ndryshme në lidhje me atë se kryerësi i veprës së vjedhjes apo shpifjes mund të falet nga viktimë, ku sipas shkollave Hanefi dhe Maliki, falja nga viktimë për kryerësin pasi që kryerësi është i akuzuar dhe i dënuar është e pa rëndësishme, kurse sipas shkollave Shafi dhe Hanbeli , falja post festum nga ana e vetë viktimës mund të paraqitet si favor dhe e njëjta mund ta zvoglojë ndëshkimin e kryerësit të veprës për veprat e vjedhjes dhe shpifjes. Andaj duhet të theksohet se krimet e ashtuquajtura hudud nuk mund të falen nga ana e kreut të shtetit apo gjykatësit dhe këto krime duhet të provohen në mënyrë sa më profesionale dhe me standarte të larta të provave me qëllim që kryerësi të ndëshkohet duke pasur parasysh edhe ashpërsinë e dënimeve, ndërsa krimet e qesas të cilat përbëjnë sulm ndaj jetës dhe integritetit fizik të personve dhe për këto vlen kompensimi i viktimës i njohur si dija.

¹²Besa Arifi “The Head Of State’s Right to Pardon – In History And Today” II Turk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri, fq.559

¹³Besa Arifi “The Head Of State’s Right to Pardon – In History And Today” II Turk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri, fq.559

Autorët islam pajtohen se kategoria e krimeve qesas u nënshtrohen faljes nga ana e vetë viktimës nëse ai është gjallë ose nga trashëgimtarët e tij nëse ai ka vdekur, por në lidhje me këtë ka interpretime të ndryshme për atë se falja jepet me ose pa kompenzim (dija), kështu shkollat islamike (Shafii dhe Hanbeli) konsiderojnë se falja e krimeve të qesasë mund të jepet nga viktimia apo trashëgimtarët e tij pamarë parasyshtë se kompenzimi (dija) është dhënë ose jo, ndërsa shkollat (Hanefi dhe Maliki) bëjnë dallim në rastet kur është dhënë kompenzimi (dija) atëherë llogaritet si marrëveshje dhe nuk konsiderohet si falje , ndërsa në rastet kur nuk është dhënë kompenzimi atëherë mund të konsiderohet si falje.

Ajo që mund të llogaritet si çështje për të cilën të gjitha shkollat islamike bijen dakort është fakti se krimet e qesas mund të falen vetëm kur ekziston vullneti I viktimës ose trashëgimtarëve të tij, që nënkupton se pa pëlqimin e tyre gjykatësi dhe kreu I shtetit nuk mund t'i falin këto krime sepse ato llogariten si sulm ndaj të drejtave personale. Profesori Akif Aydin në librin e ti "Türk Hukuk Tarihi" thekson se : " edhe kur nuk ka viktimë për të ngritur padi kundër kryerësit të krimit të qesasë ose nuk ka ndonjë person tjetër I cili ka të drejtë ta realizoj këtë atëherë gjykatësi (kadi) ose institucion tjetër shtetërorë e ndjekin penalisht sipas detyrës zyrtare dhe në këtë rast shteti nuk mund të tërhiqet nga ndjekja e atij krimi dhe as nuk mund ta falë atë. Në këtë rastë shteti përveç dënimeve të krimeve të qesas apo të kompenimit (diyya), shteti mund të shkatojë edhe një dënim shtesë të ta'aziir për një krim të qesas, kjo nënkupton se në këto situatë edhe nëse vetë viktimia apo ndonjë I afërt I tij heqin dorë nga dënimi i qesas ose kompenzimit dhe e falin viktimën , dënimi i dhënë nga shteti si dënim ta'azir do të mbetet dhe i njejt do të ekzekutohet me detyrim pasi që institucionet shtetërore nuk kanë të drejtë të falin krimet e qesasë."

Duke analizuar kuptimin e krimeve të ta'azirit të cilat nuk përbëjnë sulme kundër të drejta personale të qytetarëve të tjerë ata mund tu nënshtrohen faljes nga kreu i shtetit, siç shpjegon edhe autori Bassiouni se në krimet e ta'azirit qëllimi I dënimit duhet të jetë korrektues-përmirësues, për këtë qëllim ekziston një gamë e gjërë diskrecionale që i jepet gjyqtarit i cili duke i patur parasyshtë edhe kriteret si : interesi social në ndjekjen penale të rastit, rehabilitimi I kryerësit, përmbushja e premtimeve ndaj viktimës (kompenzimi i viktimës), korigjimi ose ndëshkimi të një norme, si dhe duke patur në konsideratë se dënimet ndaj krimeve ta'azir nuk

duhet të jenë të ashpra është e qartë se e drejta për ti falur këto krime konsiderohet në një mënyrë një institut i penologjisë që synon risocializimin dhe korrigjim e kryerësit të një krimi më pak serioz ose të një krime me pasoja jo shumë serioze. Gjithastu duhet të theksohet se krimet hudud dhe qesas kanë aktuar denime rreptësisht të përcaktuar, ndërsa për krimet ta'azir është e parashikuar aplikimi të një minimum dhe maksimumi të dënimit, prandaj ekziston mundësia shtesë e gjyqtarit për të vendosur dënimin e drejtë duke i pasur parasyshë rrethana lehtësuese dhe rënduese.¹⁴

Sa I përket autoritetit që ka të drejtë për të falë që rrjedhin nga rregullat e theksuara më lartë, si subjekte që mundë të japin falje për krimet e qesas, për dy krime të caktuara të hudud(vjedhje dhe shpifje) dhe për krime të caktuara ta'azir që nënkupton se të drejtat personale janë ekskluzivisht të viktimës dhe trashëgimtarëve të tij, ndërsa për krimet të tjera të ta'azir falja mund të jepet ose nga gjyqtari në kompetencën e tij diskrecionale për të hequr dorë nga rasti ose nga kreu i shtetit.

2.2.2. KONCEPTI I KRIMEVE DHE DËNIMEVE TË SIYASAH- KOSTOJA E TË QENIT NË SHËRBIMIN E PERANDORIT

Ka pasur raste kur ligji i rreptë dhe shpesh i ngurtë penal i Sheriatit u tregua i pamjaftueshëm për sunduesit osmanë për të ekzekutuar fuqinë e tyre absolute si perandorët që ata ishin. Prandaj, u krijua një kategori e veçantë ligjore e quajtur Siyazah. Kategoria bashkëkohore e Siyasi Suclar, e cila tregon veprat politike dhe veprat kundër shtetit, rrjedh nga koncepti i vjetër i Siyazah, i cili në anën tjetër mbulonte një spektër më të gjerë të veprave penale nga ajo që aktualisht njihet si krime politike.

Uriel Heyd shpjegon konceptin e Siyazah si krime që i nënshtrohen një 'dënimi administrativ' për arsye administrative ose politike. Një dënim i tillë, tregon ai, nuk bazohet në Sheriatin, por në vullnetin e Sulltanit: "Në përputhje me praktikën e vjetër muslimane dhe traditat e vjetra turke dhe mongole, sundimtari ka të drejtë, nëse interesimi publik ose arsyet e kërkojnë atë, të shkaktojë dënim të ashpër ndaj kriminelëve që, sipas ligjit islam, janë përgjegjës vetëm për një ndëshkim më të lehtë (ose për asnjë ndëshkim fare)."

¹⁴ Besa Arifi "The Head Of State's Right to Pardon – In History And Today" II Turk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri, fq.560

I vetmi subjekt i pranuesëm për të zbatuar *Siyâseten* ishte Sulltani ose Veziri i Madh i tij. Për më tepër, siç tregon Heidi, "ashtu siç sulltani (ose veziri i madh) mund të imponojë zbatimin e dënimit me vdekje *Siyâseten*, ashtu që ai mund të falë një kriminel ose ta zëvendësoj dënimin e tij në një më të lehtë", e cila ilustron lirinë e diskrecionit të dhënë autoriteteve më të larta në lidhje me këto krime të caktuara. Për më tepër, ai thekson se sulltani dhe zëvendësi i tij, Veziri i Madh, i cili kishte vetëm të drejtën për të zbatuar dënimin *Siyâseten*, ishin (formalisht të paktën) jo të kufizuara nga *kânün*, rregullat e të cilave mund të ndryshonin në çdo kohë, megjithëse ata iu nënshtruan Sheriatit ku për sa i përket kânunit Sheriati ishte mbi të, 'mbi ligjin'. Padyshim, kjo praktikë përfaqëson thelbin e fuqisë absolute që sundimtari kishte në Perandorinë Osmane. Sidoqoftë, duhet marrë në konsideratë se formalisht, Sulltani dhe Veziri i Madh ishin gjithmonë të lidhur nga Sheriati, madje edhe kur ata ndëshkonin *Siyâseten*.

Dënimet e Syasah ishin dënime të ashpra jashtëgjyqësore të dhëna zyrtarëve të rangut të lartë kryesisht në rastet e korrupsionit politik që u shkaktuan drejtpërdrejt nga Sulltani ose Veziri i Madh pa ndonjë shqyrtim paraprak, të legalizuar zakonisht nga një fetva, e cila nuk mund të zëvendësohet me një Gjobë dhe duhet ekzekutim i detyrueshëm, pra përgjegjësia penale e zyrtarëve të Perandorisë Osmane ishte shumë më e gjerë në krahasim me përgjegjësinë penale të qytetarëve të zakonshëm të cilët konsideroheshin popull të lirë, për arsye se ata kishin respektuar Ligjin e Sheriatit dhe konceptin Syasah.

Arsyetimin e ekzekutimit të krimeve Syasah nga ana e Sulltanit me anë të një fetfaje për herë të parë e ka përcaktuar studiuesi i njohur ligjor I asaj periudhë të shekullit XVI i quajtur Dede Efendi, siç shpjegohet nga autori Heyd: "Dede Efendi shpreh mendimin e përgjithshëm të pranuar se për hir të ruajtjes së rendit publik dhe sigurimit të mirëqenies së shoqërisë, sundimtari musliman i është dhënë një diskrecion i gjerë për t'u marrë me veprat penale, me kusht që veprimet e tij të mos kundërshtojnë hapur Parimet e Sheriatit. Në veçanti, ai ka të drejtë të shkaktojë dënime më të gjera dhe më të ashpra ndaj kriminelëve sesa është e mundur sipas rregullave të kufizuara dhe të ngurta të ligjit penal të Sheriatit dhe procedurës penale. Ky autoritet extra-kanonik i sunduesit quhet siyâsa për aq kohë sa ai vepron me objektin dhe brenda kufijve të përmendur", pra siç nënkuptohet se Sundimtari ka të drejtë që të vendos për dënime më të rënda apo më të ashpra me kusht që veprimi i tillë të jetë në përputhshmëri me

parimet e Sheriatit, që do të thotë se megjithëse i jepet e drejta për të trajtuar drejtpërdrejtë krimet e siyasah, Sundimtari pritej të përmbushte kufijtë e ligjit të Sheriatit dhe të administronte drejtësinë në frymën e saj. Prandaj, mund të kuptojmë se qysh në shekullin e XVI dallohet qartë midis sundimit arbitrarë e shtypës nga njëra anë dhe sundimit diskrecional në harmoni me ligjin dhe interesin publik nga ana tjetër, që nënkupton se edhe pse i jepet e drejtë për ti trajtuar drejtpërdrejtë krimet siyasah Sundimtari (Sulltani) pritej të përmbushte kufijtë e ligjit të sheriatit dhe të administronte drejtësinë në përputhje me atë.

Është me rëndësi që të ceket edhe dallimi ndërmejt persoanve që konsideroheshin skllëvër të sulltanit të cilët gëzonin pozita të larta në Perandorinë Osmane si vezir, beglerbej, anëtar I administratës empirike ose një mbajtës I fesë dhe personave të cilët konsideroheshin të lirë. Personat të cilët gëzonin pozita ishin me një përgjegjësi më të madhe sepse ato konsideroheshin si skllëvër të sulltanit dhe ishin përgjegjës për dënime nëse ato haseshin të nëglizhonin, abuzonin ose keqpërdornin pozicionet e tyre, prandaj përgjegjësia kriminale e zyrtarëve në Perandorinë Osmane ishte shumë më e gjerë se përgjegjësia penale e të ashtuquajturve qytetarë të zakonshëm sepse ato ishin të obliguar të respektojnë Ligjin e Sheriatit dhe konceptin Siasah.

2.2.3. FALJA E KRIMEVE “Siyasah”

Në bazë të asaj që është përshkruar edhe më lartë, krimet e ashtuquajtura siyasah i nënshtroheshin faljes nga Sulltani ose Veziri i Madh, i cili në lidhje me këtë kategori të krimeve kishte të drejtën të shkaktojë dënime më të ashpra sesa ato të përshkruara nga sheriatit, pra edhe të drejtën për të falur e kishte posaqërisht Sulltani ose Veziri I Madh por vetem për krimet e ashtuquajtura siyasah ndërsa krimete e quajtura “hudud” ose “qesas” sundimtari nuk mund t’i falte.

Legjislacioni penal osman dallon ndërmjet *faljes së përgjithshme* dhe *individuale*, që tregon rrënjët e amnistisë dhe faljes në kohët moderne (amnistia është falja e përgjithshme e dhënë nga organi legjislativ, ndërsa falja individuale jepet nga kreu i shtetit). Autori Mustafa Avçi, në librin e tij “ Turk hukuk tarih Dersleri” shpjegon se; “ falja e *përgjithshme* nga sundimtari ishte dhënë gjatë promovimit të tij në pozitën e tij si Padişah, në këto raste mund të faleshin edhe krimet siyasah”, kurse për faljen *individuale* Avçi tregon rastin e Hasan Paşa, i cili ka qenë i

dënuar me vdekje gjatë sundimit të Sulltan Mustafës II dhe madje kishte vrarë edhe zyrtarin që ishte i detyruar të ekzekutonte dënimin e tij dhe më pas ka ikur, ai më vonë u fal nga Sulltani Ahmed III kur u ngjit në front në 1703. Falja mund të ndodhë pavarësisht nga ngjitja në front, siç është rasti i Hasan Paşa Rusçuk i cili u dënua gjithashtu për një krim siyasah dhe më pas u fal përgjithësisht nga Selim Giray III në shekullin e XVIII-të.

Fakti që të dy rastet tregojnë raste shumë specifike që lidhen me sundimtarët e shekullit të 18-të, i drejtohet qartë realitetit që krimet siyasah ishin të rralla dhe vetëm në rrethana të jashtëzakonshme u falën, kryesisht në gjysmën e dytë të historisë së Perandorisë Osmane, kur shteti i madh ishte tashmë thellë në rënijen e tij. Nga ana tjetër, gjatë periudhës në rritje të Perandorisë Osmane që përfundoi me Sulejmanin e Madhërisëm, të gjithë dijetarët pajtohen se sulltanët sundues ishin të një karakteri të fortë dhe të rreptë, shumë mirë të përgatitur për pozitën e tyre nëpërmjet përvojës së fituar më parë të qeverisjes me sançak, të cilët iu bindën ligjit dhe ndëshkonin ashpër çdo tregues të korrupsionit. Kjo ishte koha kur personat në pozita shumë të larta u ekzekutuan shumë lehtë për krimet "siyasah", pavarësisht lidhjeve të forta që mund të kishin me sundimtarin.

Në këtë drejtim, autori Heyd shpjegon se "*vëzhguesit evropianë në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë u impresionuan nga efikasiteti, efektiviteti dhe madje drejtësia e administratës osmane të drejtësisë penale*"¹⁵. Pa dyshim, ashpërsia e sistemit u tregua gjithashtu duke theksuar se 'Vlera e vogël ishte e lidhur me jetën, gjymtyrët, pronën dhe nderin e individit. Dënimi ishte shpesh i nxituar, arbitrar dhe tepër mizor. Një udhërrëfyes perëndimor i shekullit të XVII me të drejtë vërejti the theksoi se "drejtësia osmane do të shfarosë më lehtë dy burra të pafajshëm, sesa të lirohet një shkelës" Sepse në ekzekutimin e një të pafajshmi, ata mendojnë se nëse ai do të konsiderohet fajtor, shembulli punon ashtu si dhe nëse ai ishte fajtor ". Kjo qasje është në thelb e ndryshme nga qëndrimi i gjetur në Ligjin e Përbashkët, ku parimi themelor i procedurës gjyqësore kundërshtuese konsiston në 'më mirë t'i lejosh dhjetë kriminelëve të lirë se sa të dënojnë një person të pafajshëm'. Sidoqoftë, përveç aspekteve negative të lidhura me sundimin arbitrar dhe mungesën e proceseve të rregullta dhe parimeve të

¹⁵ Besa Arifi "The Head Of State's Right to Pardon – In History And Today" II Turk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri, fq.559

gykimit të drejtë, krijimi i konceptit të përgjegjësisë së gjerë të zyrtarëve në krahasim me qytetarët e zakonshëm është një parim i vlefshëm që shihet si një ndër më të dobishmet dhe efektive në kohët moderne.

Nga kjo analizë e rregullimi të së drejtës së faljes në ligjin penal osman kuptojmë se e drejta e faljes I është dhënë kreut të shtetit (sundimtarit) dhe është shumë e kufizuar sipas këtij sistemi ligjor që ka shërbyer gjithashtu si burim kryesor i ligjit në pernadorinë osmane. Pasiqë sistemi sheriatik i krimeve ishte I ndarë në tre pjesë, kompetenca krekrëve të shtetit për ti falur krimet ishte e kufizuar vetëm në një të tretën e tyre të cilat ishin të përbërë nga krimet “ta’azir” që nuk shkaktonin dëm personal dhe mund të thuhet se e drejta e kreut të shtetit për të falur ishte e kufizuar, kurse në Pernadorinë Osmane krimet “siyasah” që ishin të pagëzuara nga sundimtari ishin jashtëzakonisht rallë të falur, pasi ideja e ekzistencës së tyre shihte ne fakt të ndëshkonte korupsionin e zyrtarëve të rangut të lartë në vend që të falte atë, prandaj ato u kombinuan me masa të tjera si konfiskimi I gjërë I pasurisë si dhe ndalimi i zëvendësimit të dënimit me gjobë.

KAPITULLI III

3.TRAJTIMI JURIDIKO PENAL I INSTITUTIT TË FALJES

3.1.NOCIONI DHE KUPTIMI I INSTITUTIT TË FALJES

Që në kohërat më të lashta prej shfaqjes të së drejtës penal shteti dhe e drejta kanë parashikuar të drejtën e faljes , e rezervuar për kryerësin e veprës penale e cila ka qenë dhe është e shprehur nëpërmjet autorizimit të dhënë personit konkret në kuadër të shtetit me qëllim që ndaj kryerësit të veprës penale të mos ngritet ndjekja penale ose të dënuarit t'i zbutet dënimi apo të lirohet nga vuajtja e dënimit. Me këtë, nënkuptojmë se instituti I faljes është instituti i vjetër i të drejtës penale që është njohur që në të drejtën romake dhe në të drejtën e mesjetës, gjithashtu edhe në të drejtën penale të shteteve bashkëkohore që parashohin amnistinë dhe faljen si mjete penalo juridike. Shteti nëpërmjet institutit të faljes (amnistia dhe falja) verteton supremacionin e saj të shprehur nëpërmjet perfaqësuesve në organet më të larta shtetërore, parlamentit(në formë të ligjit) dhe shefit të shtetit si sovran(me vendim), pra amnistia dhe falja janë akte specifike të organeve më të larta shtetërore në lëmin e jursiprudencës penale me të cilat bëhen ndryshime në favor të personit të dënuar, këto institute janë e drejtë diskrecionale e organeve të përmendura, këto nuk janë e drejtë e personit të dënuar.¹⁶ Duhet të theksohet se në kuadër të së drejtës penale kriteret për dhënien e amnistisë dhe faljes nuk janë përcaktuar dhe me qëllim të evitimit të keqpërdorimeve eventuale për zbatimin e institutit të faljes (aministisë dhe faljes) duhet të sigurohet kontrollë dhe mbikqyrje nga ana e palamentit.

Në literaturën juridiko-penale ekzistojnë mendime të cilat e arsyetojnë zbatimin e institutit të faljes dhe mendime të cilat e kundërshtojnë zbatimin e të njejtës. Për arsyetimin e zbatimit të institutit të faljes ekzistojnë shumë shkaqe ku ndër më të rëndësishmet janë:

1. Në aspektin penalo-juridik amnistia dhe falja janë mjete të përshtatshme për përcjelljen e ndryshimeve shoqërore ngase në kushte bashkëkohore jo rallë herë ndodh që disa vepra

¹⁶ Ismet Saliu: E drejta penale(pjesa e përgjithshme), Prishtinë, 2003, fq.569

penale me ndryshimet përkatse shoqërore të humbin shkallën e reziqshmërisë që e kanë patur në momentin e nxerrjes së ligjit penal. Për këtë arsye masa dhe lloji I dënimit të shqiptuar më herët konsiderohet shumë i reptë dhe me anë të amnistisë apo faljes zbutet dënimi i shqiptuar apo abrogohet në tërësi pa mos e ndryshuar aktgjykimin me të cilën është shqiptuar dënimi.

2. Instituti I faljes ka efektin pozitiv të vetë personat e dënuar për të treguar një sjellje të mirë gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet penitensiare, pra falja dhe amnistia e luajne rolin e stimulit për personat e dënuar dhe që janë në vuajtje të dënimit pasi që me anë të këtij instituti u bëhet me dije se mund t'u falet një pjesë e dënimit.

3. Shfrytëzimi i amnistisë dhe faljes vjen në shprehje edhe për raste si mënyrë për përmisimin e gabimeve gjyqësore e cilat konstatohen pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike në procedurë penale.

4. Në disa raste amnistia dhe falja mund të jepen për arsye humane apo për interesa shtetërore dhe politike. Zbatimi i amnistisë dhe faljes vjen në raste kur vepër penale ka kryer ndonjë person i cili ka vlera dhe merita të jashtëzakonshme për çlirimin dhe ndërtimin e vendit. Kurse në rastet kur janë në pyetje interes shtetërore e politike, amnistia dhe falja mund të jepen nëse ndjejka penale, ndëshkimi apo mbajtja e mëtejshme e dënimit nga personi i caktuar çënon rëndë autoritetin e shtetit apo marrëdhëniet e atij shteti me shtetin tjetër, apo marrëdhëniet e atij shteti me organizatat ndërkombëtare si psh. me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, me Unionin Evropian, me Këshillin e Evropës etj.

5. Me anë të amnistisë dhe faljes shprehet mençuria shtetërore dhe politike, sepse me anë të këtyre institutive në raste të caktuara bëhet e mundshme që të merren parasyshë rrethana juridike dhe shoqërore-politike të cilat në një masë arsyetojnë dhe diktojnë aplikimin e tyre.

Sa i përket mendimeve të cilat e kundërshtojnë zbatimin e institutit të faljes, ata datojnë që nga kohërat më të vjetra kur, institutit i faljes ka marrë karakter të intervenimit anësor në pushtetin gjyqësorë si dhe favorizimi i kriminelëve me zbatimin e të njejtit. Gjithashtu arsyetimi për kundërshtimin e këtij instituti ka të bëjë edhe me argumentin e përzijerjes së palejuar të

qeverisjes ekzekutive në vendimet e plotfuqishme të gjyqësisë sovrane dhe të pavarur.¹⁷ Ndër autorët të cilët e kanë kundërshtuar zbatimin e këtijë institut është edhe Cesare Beccaria një studiues juridik I epokës iluministe të shkollës klasike të së drejtës penale i cili thekson se amanistia dhe falja duhet të ndalohen së zbatuari tërësisht në një system ligjor ideal ku zbatimi I parimit të ligjshmërisë siguron sundimin e ligjit në të cilën çdo person I dënuar në procedurë gjyqësore sipas ligjit duhet të vuaj plotësisht dënimin e tij.

Në bazë të rregullativës juridike insituti i faljes, pra amnistia dhe falja mund të jepen për të gjitha veprat penale edhe për veprat penale të cilat ndiqen me anë të padisë private. Aktgjykimi me anë te amnsistisë dhe faljes nuk anulohet por edhe më tutje konsiderohet i ligjshëm.¹⁸

Me anë të amnistisë dhe faljes nuk çënohen të drejtat e personave të tretë, të drejta të cilat mbështeten në dënimin e shqiptuar, pra, të gjithë personat që janë të dëmtuar me vepër penale edhe në raste kur jepet amnisitia apo falja kanë të drejtë të kërkojnë kompenzimin e dëmit, gjithashtu edhe në rastin kur jepet abolacioni , edhe pse nuk është shqiptuar dënimi për veprën penale personat e dënuar kanë të drejtë të kërkojnë kompenzimin e dëmit. Instituti i faljes duhet të ushtrohet me maturi dhe vigjilencë sepse zbatimi e paarsyeshme I amnistisë dhe faljes ndikon në mënyrë negative në vetë efektin e aktgjykimit , gjykatat, opinionin publik dhe në qëndrimin e gjykatave në lëminë e matjes së dënimit si dhe në shqiptimin e sanksioneve penale në përgjithësi.¹⁹

Legjislacioni i vendit tonë është përshtatur mirë me legjislacionin e vendeve perëndimore dhe nga kjo pikëpamje mund të themi se kemi një legjislacion bashkëkohorë, në këtë drejtim vlen edhe për institutin e faljes dhe rregullumin juridik të saj.

3.2. FALJA

Duke analizuar dhe kuptuar qëllimin e dënimit me burg në ditët e sodit që më shumë ndërldidhet me përmisimin e sjelljeve të të dënuarve ashtu që të arihet sa më shumë risocializimi dhe riintegrimi I plotë I personave të dënuar ,andaj instituti i faljes shihet si një mekanizëm

¹⁷ KAMBOVSKI Vllado " Edrejta penale pjesa e përgjithshme";(përkthim në gj.shqipe Afrim OSMANI dhe Ismail ZEJNELI), Shkup, fq.630

¹⁸ Ismet Saliu: E drejta penale(pjesa e përgjithshme), Prishtinë, 2003, fq.570

¹⁹ Ismet Saliu: E drejta penale(pjesa e përgjithshme), Prishtinë, 2003, fq.570

mjaftë I rëndësishëm sidomos në vendet në të cilat është zbatuar dënimi me vdekje, kështu që falja shihet si një mjet për të treguar mëshirë për të dënuarit, pra falja është një institut i së drejtës penale me anë të së cilës tentohet të shpërblehen të dënuarit për veprat penale, të cilët kanë kryer borxhin e tyre ndaj shoqërisë për shkeljet e bëra. Rrjedhimisht rikthimi I të dënuarve do të duhej të paraqesë më shumë dobi sesa problem për shoqërinë në përgjithësi, andaj falja si e tillë duhet të synojë të ndërtojë mbi këto parime, duke i shërbyer të mirës së përgjithshme.

Falja është akt të cilin e nxjerr kryetari I shtetit ose qeveria, pra falja paraqet një vendim qoftë të Presidentit apo të qeverisë përmes së cilës personat e caktuar emër për emër lirohen nga ndjekja penale, lirohen plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi I dënimit, zëvendësohet dënimi I shqiptuar me dënim më të butë apo me dënim me kusht²⁰. Në bazë të Ligjit për Falje të publikuar në “Gazetën Zyrtare të RM” me numër 20/93 dhe 12/09 neni 1 përcakton se: “Presidenti I shtetit të Republikës së Maqedonisë e jep faljen personave të përcaktuar emër për emër për veprat penale të parapara apo të parashikuara në ligjet e Republikës së Maqedonisë, në pajtueshmëri të dispozitave të Kodit Penal (KP) dhe të dispozitave të këtij ligji (Ligji për Falje)²¹. Neni 1, paragrafi 2 I Ligjit për falje “Kryetari I Republikës së Maqedonisë me falje liron nga ndjekja, ose plotësisht ose pjesërisht liron nga vuajtja e dënimit, e zëvendëson dënimin e shqiptuar me dënim më të lehtë (butë) ose me masë alternative, ose përcakton shlyerjen e dënimit, ose e anulon, gjegjësisht përcakton kohëzgjatje më të shkurtër të pasojës së caktuar juridike prej dënimit ose ndëshkimit²². Paragrafi neni 1 , paragrafi 3 I Ligjit për Falje “Me falje mund të caktohet ndërprerja ose kohëzgjatja më e shkurër e këtyre dënimeve: ndalesë e kryerje së profesionit , veprimtarisë ose detyrës, ndalesë për drejtimin e automjetit kryerësve të veprave penale që janë vozitës me profesion dhe dëbim I të huajit nga vendi”²³. Pra, me anë të ligjit për falje kuptojmë në mënyrë të detajuar vetë kuptimin e faljes në rradhë të parë, kompetencat e kryetarit të shtetit për zbatimin e aktit të faljes si dhe veprat penale për të cilat mund të merret vendimi për falje, që nënkuptojmë se si autoriteti për zbatim të këtij akti specifik është vetëm kryetari I shtetit kompetencat e të cilit janë të përcaktuar me vetë kushtetutën e shtetit në rradhë të parë si e drejtë për të falur si dhe të rregulluar në mënyrë më të detajuar nëpërmjet ligjit për falje.

²⁰ Ismet Salii, E drejta Penale: Pjesa e përgjithshme (prishtinë: Universiteti Fama, 2008), Kapitulli VII: Amnistia dhe Falja, fq.596

²¹ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë, (“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09), neni1, paragrafi 1, v. 2016

²² Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë, (“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09), neni1, paragrafi 2. v. 2016

²³ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë, (“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09), neni1, paragrafi 3, v. 2016

Instituti i Faljes është institut që ka veprim të njejtë si edhe amnisita, me dallime të vogla që nuk e ndryshojnë bazën e saj në akt të faljes me të cilën personave të caktuar, në mënyrë nominale u jepet lirim nga ndjekja ose lirim I pjesshëm ose I plotë prej kryerjes së dënimit, I zëvendësohet dënimi I shqiptuar me dënim më të butë, ose me masë alternative, ose I përcaktohet shlyerje të dënimit, ose I hiqet gjegjësisht I përcaktohet afat më I shkurtër I pasojës së përcaktuar juridike, përveç kësaj me faljen mund të përcaktohet heqja ose afat më I shkurtër I dënimit, ndalesë për të kryer profesion, veprimtari ose detyrë, ndalesë për të drejtuar automjete, kryerësve të cilët janë vozitës me profesion dhe dëbimin e të huajit nga vendi(neni 114 I KPM),Falja u jepet personave të caktuar në mënyrë nominale me vendim, kurse *kopmetent* për falje është *Presidenti I Republikës së Maqedonisë*(neni 81 I Kushtetutës).²⁴

Në literaturën juridiko-penale theksohet edhe për një formë të faljes e quajtur si abolacion me lirim nga ndjekja penale, ku ***abolacioni*** është amnestia apo falja me të cilën kryerësi i VP lirohet nga ndjekja penale dhe paraqet formën më të gjërë të amnesitës apo faljes, sepse mund të jepet në të gjitha fazat e procedurës penale derisa nuk është nxjerë aktgjykimi I plotëfuqishëm. Profesori Ismet Saliu në librin e tij “ E drejta e proceruës penale” thekson se :”Me anë të abolacionit procedura nuk mund të fillohet e në rastëse procedura është filluar, ajo ndalet. Efektet e abolacionit janë më të mëdha ngase kryerësit të veprës penale nuk I shqiptohet dënimi, madje edhe vepra për të cilën I është dhënë abolacioni nuk mund të merret për bazë si recidivist nëse kryen vepër tjetër penale. Falja mund të jepet për të gjitha veprat penale, duke përfshirë edhe veprat penale që ndiqen sipas padisë private. Cështja e zbatimit të institutit të abolacionit është çështje e vullnetit të vendeve të cilat këtë të drejtë ti’a japin apo kufizojnë shëfit të shtetit. ”

3.2.1. BAZA LIGJORE

Në Republikën e Maqedonisë, falja si edhe në një pjesë të madhe të shteteve është kompetencë e Presidentit të vendit e garantuar me Kushtetutën e vendit. Në RM falja parashihet me kushtetutë në të cilën përcaktohet kompetenca e Presidentit të Republikës së Maqedonisë , respektivisht në të cilën theksohet se Presidenti jep falje dhe paraqet pushtet të jashtëzakonshëm ekzekutiv dhe të drejtë diskrecionale të Presidentit, më saktësisht kjo çështje

²⁴ KAMBOVSKI Vllado “ E drejta penale pjesa e përgjithshme”;(përkthim në gj.shqipe Afrim OSMANI dhe Ismail ZEJNELI), Shkup, fq.630

shprehet në nenin 79 dhe neni 84 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë tek kapitulli për Kompetencat e Presidentit, ku thuhet se Presidenti: “bën faljen në pajtim me ligjin”.²⁵

Deri tek jetësimi i të drejtës për të falur ka ardhur me hartimin dhe miratimin e akteve ligjore rreth institutit të faljes sipas kërkesave të Kushtetutës. Zbatimi i faljes gjithashtu është e rregulluar edhe me ligj të veçantë (lex specialis) respektivisht me Ligjin për Falje i cili specifikon ecurinë rreth zbatimit në tërësi të institutit të faljes. Në bazë të këtij ligji falja nënkupton vendimi me të cilin vjen deri te lirimi i personave të dënuar të cilën mund ta bëjë Presidenti i shtetit, në të rregullohet procedura dhe kriteret për dhënien e faljes.

Në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë përkatësisht në nenin 97, thekson saktë se çfarë parasheh falja dhe se kujt i takon kjo e drejtë.

Me ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale përcaktohet se të falurit e Presidentit të cilëve u përfundon i gjithë dënimi i shqiptuar nga gjykata, lirohen menjëherë apo më së paku brenda 24 orëve pas dorëzimit të Dekretit të Presidentit tek institucioni korektues-përmisues përkatës.

3.2.2. KRITERET

Duke I pasur parasyshë se për aplikimin e instituteve juridike në një shtet zbatohen kriteret të ndryshme ashtu edhe instituti i faljes në RM ekzekutohet në bazë të disa kriterëve. Kriteret të zbatimit të institutit të faljes janë të përcaktuara me Ligjin për falje të RM-së për veprat penale të përcaktuara me këtë ligj si dhe me KP të RM-së respektivisht me neni 5-a të ligjit për falje të RM-së. Gjate shkqyrtimit të propozimeve për falje presidenti respektivish komisioni I formuar nga ana e presidentit duhet ti ketë parasyshë repektimin e disa kriteriumeve dhe atë:

- Natyrën, llojin dhe rëndësia e veprës penale të kryer,
- personaliteti i kryerësit, jeta e tij e më parshme, sjellja e personit të gjykuar pas gjykimit dhe gjate periudhës së vuajtjes së dënimit, respektivish ndaj veprës penale të kryer, dënimi i mëparshëm, shkalla e aritjes së risocializimit, mosha dhe gjendja shëndetsore të të dënuarit dhe kushtet e tij familjare, dhe

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Teksti jo-zyrtarë, I spastruar për përdorim intern) përkthyer nga Prof. Dr. Kurtesh Salii, Fakulteti juridik-UEJL Tetovë, 2007, neni 79 paragrafët 1 dhe 2 dhe neni 84, fq. 31 dhe 33-34

- ndikimi I aktit të faljes në rrethin nga vjen personi I dënuar dhe rrethi ku ai e ka kryer veprën penale.²⁶

Këto kritere vijnë në shprehje sepse falja si një mekanizëm jo I rregullt qëllimin e saj e ka për t'i shërbyer vetëm të dënuarit me anë të një vendimi përfundimtarë gjyqësor të cilët kanë treguar sjellje dhe karakter të jashtëzakonshëm gjatë vuajtjes së dënimit. Gjatë marrjes në shqyrtim si dhe gjatë vendosjes për faljen e personit, akti I faljes duhet gjithmonë të bazohet në sqarim racional të caktuar, të ketë bazë racionale, sepse nuk është instrument I fuqisë politike dhe vetëdëshirës , por instrument I drejtësisë.

Përveç kriterëve të cilat janë të përcaktuara me ligjin për falje, gjatë zbatimit të ligjit duhet të kihet parasysh edhe respektimi I disa parimeve bazike dhe atë:

- peshën e krimit,
- rrezikun për recidivizëm,
- pendimin e sinqertë, si dhe
- shfaqjen e sjelljeve dhe karakterin e respektueshëm.²⁷

Përveç kushteve të përcaktuara në Ligjin për falje për zbatimin e institutit të faljes, po me këtë ligj janë përcaktuar dhe ndalesat,përkatësisht ligji ka ndaluar kategorikisht dhënien e faljes për disa vepra penale dhe atë:

- Veprat penale kundër zgjedhje dhe votimit nga kreu XVI i Kodit penal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 37/96, 80/99, 4/2000, 43/2003, 19/2004, 60/2006, 73/2006, 7/2008 dhe 139/2008), ku në këtë grup hynë veprat penale kundër pengimit të së drejtës për zgjedhje dhe votime, veprat kundër shkeljes së të drejtës zgjedhore, shkelja e së drejtës të përcaktimit në zgjedhje, keqpërdorimi I të drejtës zgjedhore, korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimeve, cënimi I fshehtësisë së votimit, asgjësimi I dokumenteve zgjedhore dhe mashtrimi në zgjedhje.
- Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor nga kreu i XIX i Kodit penal të kryera ndaj fëmijëve dhe personave të mitur,ku hynë dhunimi, kryerja e aktit seksual kundër personit të pa

²⁶ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë,(“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09) , neni 5-a, paragrafi 2, v.2016

²⁷ MUSLIU Betim&GASHI Adem “Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe liritimit me kusht”, Prishtinë, janar 2012, fq. 11

aftë, kryerja e aktit seksual me keqpërdorim të pozitës, mundësimi i prostitucionit, tregimi i materialit pornografik fëmijëve,

- Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve nga Kreu XXI, ku hynë shkelja e barazisë së qytetarëve, mos veprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë kohës së epidemisë, mjekimi I pa ndërgjegjshëm I të sëmurëve, mos dhënia e ndihmës mjekësore, ushtrimi I mjekësisë nga personi që nuk ka kualifikim-pseudomjekësia,
- Vepra penale prodhim I paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave narkotike dhe prekursorëve nga neni 215,
- Vepra penale mundësim I përdorimit të lëndëve narkotike nga neni 216
- Vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare nga Kreu XXXIV I kodit penal ku ndër tjera hynë gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës që janë në kundërshtim me konventat ndërkombëtare, kontrabandimi me emigrant, trafikimi me njerëz dhe perpat penale që ndërlidhen me personelin ndërkombëtarë.²⁸

Vendimi për falje nuk mund ti jepet edhe ndonji personi në përgjithësi ku profesori Vlado Kambovski ku e ka fjalën , ti jepet falja personi për ndonjë vepër penale të ardhshme pra , vepër penale e cila ende nuk është kryer. Si paragraf I veçantë në ligjin për falje parashihet edhe neni 1,paragrafi I 3 në të cilën theksohet edhe ky lloj kufizimi ndaj kryetarit të shtetit: "Kryetari i Republikës së Maqedonisë nuk mund t'I japë falje personit shtetas të Republikës së Maqedonisë, I cili vuan dënim në RM, kurse është dënuar me aktgjykim të Gjykatës penale ndërkombëtare".²⁹ Falja e veprave penale të ndaluara përbën shkeljë flagrante të Kushtetutës së Republikës së Maqedonise dhe Ligjit per Falje.

Në literaturën shkencore Juridiko-penale theksohet se me zbatim të institutit të faljes vjen deri te shuarja e dënimit, ku me anë të faljes personave të dënuar iu falet dënimi në tërësi apo pjesërisht, iu zëvendësohet dënimi me dënim më të butë, iu shlyhet dënimi nga evidence e të ndëshkuarëve apo falen duke I liruar nga ndjekja penale. Në Shqipëri Ligji për falje vendos se falja u takon vetëm të dënuarve me vendim të formës së prerë, në Kroaci, sipas ligjit për falje, nga falja përfitojnë vetëm personat e dënuar nga gjykata e Republikës së Kroacisë apo vuajnë dënimin dhe pasoja tjera ligjore në Kroaci. Po ashtu në Itali, Austri, Zvicër , Francë dhe vendet

²⁸ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë, ("Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09) , neni 1, paragrafi 2, v.2016

²⁹ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë, ("Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09) , neni 1, paragrafi 3, v.2016

tjera të Evropës, theksohet se falja bëhet vetëm për dënimet e shqiptuara , ndërsa në Gjermani një gjë e tillë nuk përmendet.

Me përcaktimin e kriterëve për zbatimin e të drejtës për falje si dhe me përcaktimin e ndalimit të dhënies së faljes për veprat penale të caktuara mund të theksohet se tregohet një përparim sa I përket aspektit ligjorë në fushën e faljes në RM, mirëpo edhe pse me ligj janë parapa kriterë dhe vepra penale ndaj të cilave nuk mund të jepet falja, l'a vlenë të theksohet se kriteret aktuale më shumë favorizojnë vlerësimet subjektive, duket pa mundësuar tratim të njejtë për secilin të dënuar.

Duhet të theksohet se me anë të faljes asesi nuk duhet të çenohen të drejtat e personave të tretë, të cilët janë dëmtuar me vepër penale dhe kanë të drejtë të kërkojnë kompensim të dëmit, gjithashtu kjo e drejtë palëve të treat nuk iu cenohet as në rastet kur jepet abolacioni, pra as në rastet kur kemi të liruar nga ndjekja penale. Kjo çështje është e theksuar edhe me Kodin Penal dhe Ligjin Penal të Republikës së Maqedonisë ku qartë thekson se me dhënien e faljes nuk preken të drejtat e personave të tretë që bazohen në dënim apo aktgjykim(neni 115 LPM)

3.2.3.PROCEDURA

Procedurat për falje janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Ligjin për Falje të RM-së, ku procedurat përfshinë paraqitjen e kërkesave për falje, shqyrtimin dhe vendosjen e tyre.

Në Ligjin për Falje të RM-së në nenin 2, paragrafi 1 theksohet në mënyrë të qartë se për fillimin e procedurës për falje inicohet me paraqitjen e lutjes nga ana personit të dënuar ose në mënyrë zyrtare, gjithashtu theksohet se në emër të personave të dënuar lutjen për fillimin e procedurës për falje mund të paraqesin edhe : bashkëshorit/bashkëshortja, personat e lidhjes së gjakut në vijë të drejtë vëllau, motra, adoptuesi apo adoptuesja, dhe kujdestari. Kurse procedurën për falje në mënyrë zyrtare (exo fficio) e inicon Ministri i Drejtësisë.³⁰ Në ligjin për falje gjithashtu theksohet se për zbatim të procedurës për falje për lirim nga ndjekje penale inicimi është vetëm ex officio edhe atë kjo ceshtje përcaktohet me nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 I Ligjit për Falje : “Procedura për falje për lirim nga ndjekja penal inicohet vetëm në menyrë

³⁰ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë,(“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09) , neni 2, paragrafi 1,2 dhe 3, v.2016

zyrtare dhe mund të inicohet në çdo stadium të procedurës penale. Procedurën nga paragrafi 1 I këtij neni e inicon Ministri I Drejtësisë”.³¹

Me nenin 4 të ligjit për Falje theksohet se :” Procedura për falje është urgjente”.³²

Lutja për falje duhet të dërgohet deri te Presidenti I RM-së, nëpërmjet gjykatës e cila e ka shqiptuar aktgjykimin në shkallë të parë, kurse në rastë se lutja është dërguar deri të ndonjë organ tjetër ose institucion tjetër ata janë të obliguar që të njejtën ta dorzojnë deri te gjykata kompetente. (neni 5, paragrafi 1 dhe 2, LF.). Kur bëhet fjalë për personat të cilët gjenden ne vuajtje të dënimit , lutjen për falje duhet ta dërgojnë deri te gjykata kompetente nëpërmjet institucionit korektues-përmisues në të cilën e vuajnë dënimin, ndërsa institucioni korektues-përmisues është I obliguar që në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të lutjes duhet të jap raport për sjelljet e personit të gjykuar, përkatësisht të dhëna të tjera me rëndësi për zgjidhjen e lutjes dhe të njejtën i’a dërgon gjykatës kompetente. Në situatat kur lutja për falje për personat që janë në vuajtje të dënimit është drejtuar drejtpërdrejt në gjykatën kompetente, atëherë e njejtë të dhënat për sjelljen e personit që vuan dënimin do ti kërkoj nga institucioni koerktues-përmisues në të cilin ai e vuan dënimin(neni 5, paragrafi 3 dhe 4, LF)

Për marjen e vendimit për shqyrtimin e lutjeve dhe vendojsen e të njejtava, Kryetari I RM-së me vendim formon Komisionin për falje dhe e përcakton përbërjen dhe numrin e antarëve të Komisionit e cila sjell rregullore për punën e vet.(neni 5-a, paragrafi 1, LF).

Në nenin 6 të ligjit për falje përcaktohet se lutja për falje mund të dorëzohet apo të paraqitet pas plotfuqyeshmërisë së vendimit gjyqësor, gjithashtu përcaktohet se në raste kur një herë është paraqitur lutja për falje dhe e njejtë nuk është pranuar atëherë, pas kalimit të afatit prej 3 (tre) muajve nga dita kur është marrë vendimi I mëparshëm për lutjen mund të paraqitet lutja e sërshime për falje , kur është shqiptuar dënimi me burgim ose dënim për të mitur në afat pre 1 (një) viti atëherë lutja mund të paraqitet pas kalimit të 6 (gjasthë) muajve, kur është shqiptuar dënim me burgim më shumë se 3 (tre) vjet atëherë lutja mund të paraqitet pas kalimit të 1(një) viti. Në këtë rastë më specifike është çështja për dënimet me burgim të përjetshëm, respektivisht lutja mund të paraqitet përsëri pas kalimit të 5 (pesë) viteve nga dita e sjelljes së vendimit të mëparshëm për lutjen e parashtruar.

³¹ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë,(“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09) , neni 3, paragrafi1 dhe 2, v.2016

³² Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë,(“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09) , neni 4, v.2016

Në këtë nen respektivisht ne paragrafin e 4 te këtij neni theksohet se në rastet kur procedura është inicuar me detyrë zyrtare, afati për parashtrimin e sërishëm të lutjes nga paragrafi I 2 I këtij neni rrjedh nga dita e marrjes së vendimit për dhënien e faljes me detyrë zyrtare.

Në praktikë të paraqitjes së lutjes për falje hasen shpesh situatë kur lutja është parashtruar nga personi I pa autorizuar, apo rastet kur lutja është riparashtruar lutja për falje para se të kaloj afati I parapaë ligjor për riparashtrim të lutjes ose rastet kur parashtrohet lutja për falje për situatat për të cilat falja nuk lejohet (situatat e parapar ligjore në të cilat përjashtihet falja) , në të gjitha këto raste të parashtrimit të lutjes sipas neni 7 te LF të RM-së gjykata me vendim e hudh posht ankesën e paraësthruar nga pala. Kur gjykata e hudh posht ankesën për rastet e cekura atëher me të njejtin nen në paragrafin e dytë është parapare edhe ankesa kundër vendimit të gjykatës, respektivish në këtë paragraf theksohet se lejohet ankesa në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e dorzimit të vendimit në gjykatën e shkallës më të lartë, kurse gjykata më e lartë vendos në bazë të Ligjit për procedurë penale, në pjesën në të cilën përshkruen veprimet për ankesën kundër vendimit. Vazhdimi I procedurës rregullohet me nenin 8 të LF të RM-së me të cilën theksohet se për vendosjen mbi lutjet e parashtruar për falje, gjykata dhe organet tjera përkatëse mund të mbledhin të dhëna dhe informata të rëndësishme për vendosjen e lutjes. Gjukata para se ta dorzojë lutjen për falje deri tek Ministria e Drejtësisë I vërteton faktet dhe rrethanat të rëndësishme për vendosje në të cilat thiret parashtruesi I lutjes dhe raportin për të njejtën i'a bashkangjet lutjes. Kurse gjykata është e obliguar që lutjen për falje menjëherë ta marrë në shqyrtim dhe më së voni në afat pre30 ditë pas pranimit ta dorzojë deri te Ministria e Drejtësisë me të gjitha përshkrimet, kurse neni 9 tregon se Ministria e Drejtësisë menjëher pas pranimit e shqyrton lutjen dhe shkrimet e tjera së bashku me propozimin e sajë në afat pre 30 ditëve e dërgon deri te Presidenti I Republikës së Maqedonise. Në Ligjin për falje të RM-së përshkruhen situata apo rastet në të cilat gjykata apo Ministria e Drejtësisë e ndërpret lutjen për falje, kjo çështje rregullohet me neni 10 të LF të RM-së ku thuhet : “Gjukata , respektivisht Ministria e Drejtësisë e ndërpret procedurën për falje në qoftëse :

- personi I dënuar e tërheq lutjen për falje
- nësë e ka vuajtur dënimin
- nëse pushon pasoja juridike nga vendimi – dënimi

- nëse është sjellë vendim nga gjykata me zbatimin e rastit të jashtëzakonshëm juridik, dhe

-në rastë se personi I gjykuar vdes gjatë procedurës për falje.³³

Në rastet kur me anë të zbatimit të faljes dënimi I shqiptuar zëvendësohet me dënim me kusht atëherë do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme me rrethanat dhe kushtet e përcaktuar dhe të parapara me Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë për shqiptimin e dënimit me kusht, me kusht që koha e kontrollit të mos zgjas më tepër se 3(tre) vjet dhe ndaj dënimit me kusht nuk është përcaktuar mbikqyrje mbrojtëse si dhe personit të dënuar me dënim me kusht nuk I përcaktohet plotësimi I kushteve të posaçme.³⁴ Rastet kur me anë të zbatimit të faljes kur janë plotësuar kushtet dhe është respektuar procedura e nevojshme e paraparë me Ligjin për falje të RM-së urdhërohet të fshihet aktëgjykimi pamarëparasyshë figurës së veprës penale dhe llojit të veprës penale, gjithashtu nuk ka rëndësi se për çfarë lartësie të dënimit bëhet fjalë, kurse Ministria e Drejtësisë sjell manual të procedurës për gjykatat dhe institucionet korektuese – përmisuese për rastet e faljes, kjo çështje është e rregulluar me nenin 12 dhe neni 13 të Ligjit për Falje të RM-së

3.3. AMNISTIA

Amnistia është fjalë me prejardhje greke që nënkupton *haresë*. E drejta e shtetit për të falur personat është e drejtë e njohur në sistemin e drejtësisë, që nënkupton si e drejtë (autorizim) e shtetit që në kushte të caktuara me ligj, kundër personave kryerës të veprës apo veprave penale të mos inicohet ndjekje penale apo për personat tashmë të gjykuar me aktëgjykim të formës së prerë tu falet dënimi. Dënimi paraqet vuajtje për veprën e kryer, kurse amnistia paraqet falje të vullnetit të mirë ndaj personave të gjykuar me qëllim të dhënies së ndihmës për procesin e risocializimit të tyre.

Ky institut ka ekzistuar që në kohrat e vjetra, ku edhe në literaturën shkencore-juridike bën pjesë në kuadër të institutit të faljes, institute I cili ndahet në falje dhe amnisti. Amnistia është institute present në shumë vende të botës I rregulluar me ligje të posaçme (veçanta) dhe I përcaktuar edhe me kushtetutë të shtetit përkatës.

³³ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë,(“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09) , neni 10, v.2016

³⁴ Ligji për Falje I Republikës së Maqedonisë,(“Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.20/93 dhe 12/09) , neni 11,v.2016

Në kushtetutën e Francës është e përcaktuar se si organ kompetent për dhënien e amnistisë është kuvendi, kurse në kushtetutën e shtetit të Italisë përcaktuat se amnistia mund të sillet me 2/3 e votave, gjithashtu në Itali është e njohur edhe amnistia e përgjithshme e cila I përfshinë të gjithë personat e të dënuar me burgim, akt I tillë është sjellë në vitin 2006 me të cilën personave të gjykuar u është shkurtuar 3(tre) vite nga dënimi me burgim.

Në zbatimin e aktit të amnistisë si akt I faljes janë të njohura rregulla të veçanta në sistemin e drejtësisë të Anglisë ku për dallim nga shtetet tjera në të cilët e drejta e nxjerjes së aktit të amnistisë i takon parlamenti, këtu e drejta për dhënien e amnistisë i takon mbretit edhe pse ka raste ku edhe parlamenti ka nxjerrë aktin e amnistisë për personat e dënuar me burgim si dhe për personat pjesmarës në konflikte.

Në RM që nga pamvarsia e sajë janë sjellë disa Ligje për Amnisti. Ligji I parë për Amnisti është sjellur në vitin 1991 dhe me këtë ligjë janë mpërfshirë falja e kategorisë së personave të cilët kanë qenë në vuajtje të dënimit me burgim, gjithashtu edhe kategorija e personave të cilët ende nuk kanë qenë në vuajtje të dënimit me burgim por të cilët veç më kanë qenë të dënuar me të njëjtën. Ligji për Amnisti gjithashtu është sjellë edhe në vitin 1999 e cila ka qenë e destinuar për për kategorinë e personave të cilët kanë qenë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë me dënim me burgim për veprat penale të përfshira në Kodin Penale dhe në ligjet tjera të RM-së, të cilët nga ana e gjykatës u është shqiptuar dënimi me burgim si dënim I I vetëm, gjithashtu edhe personat të gjykar me aktgjykim të formës së prerë nga ana e gjykatave apo gjykatës të ish Republikës Jugosllave, të cilët në ditën e sjellje së këtij ligjin kanë filluar me vuajtjen e dënimit me burgim në RM.

Në vitin 2002 është sjellë Ligji për Amnisti me qëllim të vendosjes së një kornize të drejtësisë të përcaktuar me anë të Marrëveshjes së Ohrit, me këtë ligj është paraparë lirimi nga ndjekja penale, ndërprerja e procedurës penale dhe plotësisht lirimi nga dënimi me burgim të qytetarëve të RM-së, personat të cilët kanë pasur pasuri ose familje në RM dhe ndaj të cilëve ka ekzistuar dyshimi se kanë pregaditur ose kanë kryer vepra penale të ndërlidhura me konfliktin e viti 2001, nga 26 shtatori I vitit 2001. Me këtë ligj gjithashtu janë përfshirë edhe personat të cilët edhe para 1 janarit të vitit 2001 kanë pregaditur ose kanë kryer vepër penale të ndërlidhura me konfliktin e v.2001. Duhet të theksohet se me këtë akt të amnistisë nuk janë përfshirë

keqpërdorimet ndërkombëtare për të cilat është përgjegjëse Tribunali I Hagës. Gjithashtu me këtë ligj të amnistsisë është paraparë bazë edhe për lirimin nga ekzekutimi I dënimit me burgim për 25% e vuajtjes së dënimit me burgim të mbetur për personat të gjykuar dhe të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprat penale të parapara në KP dhe ligjeve tjera të RM-së edhe nëse në ditën e sjelljes së këtij akti personi ka filluar me vuajtjen e dënimit me burgim në institucionet korektuese – përmisuese të RM-së.

Ligj për amnistinë është sjellë edhe në vitin 2003 (I rrishikuar ne vitin 2004) dispozitat e të cilit kanë qenë të rreferuara qytetarëve të RM-së të cilët nuk e kanë kryer detyrimin ushtarak.

Në propozim ligjin e ri për amnisti në bazë të Ministries së Drejtësisë si përgaditëse e ligjit kurse si propozues parashihet Qeveria e RM-së, vlerësohet për nevojën e sjelljes së ligjit të ri për amnisti për të treguar vullnetin e mirë të shtetit ndaj një kategorie të caktuar të grupit të qytetarëve të cilët janë të gjykuar me aktëgjykim të formës së prerë, krejt me qëllim të risocializimit të tyre si dhe për lirimin e burgjeve nga numri I madh I të burgosurve të cilët janë në vuajtje të dënimit me burgim në institucionet korektuese përmisuese, si dhe duke pasur parasyshë edhe kushtet e vetë këtyre institucione. Me propozim ligjin për amnisti nuk parashihet amnistija për personat të cilët janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë me dënim me burgim të përjetshëm, si dhe kryerës të veprës penale Vrasje nga neni 123 i KP, veprave penale kundër zgjedhjeve të parapara në nenet 158-165-v në KP, për veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinorë të parapara në nenet : 186-191,191-a, 193-a,193-b,194 të KP, për veprat penale kundër shtetit të parapara në nenet: 305-327 të KP, për veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare të parapara ne nenet: 403-418-a, 418-b, deri 422 të KP. Si qëllime për sjelljen e ligjit të ri për amnisti theksohen : risocializimi I kryerësve të vp, lehtësim financiar I buxhetit të RM-së në drejtim të mirëmbajtjes dhe kujdesit të personave që janë në vuajtje të dënimit në institucionet korektuese –përmisuese, si dhe nevoja për forcimin e sistemit të rehabilitimit dhe ndihmesë në procesin e riintegritit të personave të gjykuar.

Në shkencën juridiko penale amnistija për dallim nga falja paraqet aktin e faljes të dhënë në formë të ligjit nga ana e parlamentit si trup më I lartë legjislativ dhe kjo jipet për personat e caktuar dhe për veprat e caktuara. Në nenin 113 të KPM amnistia përcaktohet me këtë

definicion:”Amnistia është akt I trupit legjislativ në formë të ligjit me të cilin rrethit të pacaktuar njerëzish, në mënyrë nominale u jepet liria nga ndjekja, liri të plotë ose të pjesshme prej kryerjes së dënimit, u ndryshohet dënimi I shqiptuar me dënim më të butë, u përcaktohet shlyerje të dënimit ose u hiqet pasoja e përcaktuar juridike e dënimit”. Pra nga kjo kuptojmë se amnistia përdallim nga falja ajo u jepet personave të pacaktuar emër për emër, kurse falja u jepet personave të caktuar emër për emër, me amnistinë pra personat lirohen nga ndjekja e penale , lirohen pjesërisht apo plotësisht nga ekzekutimi I dënimit, u zëvendësohet dënimi me dënim më të butë apo u caktohet shlyerja e dënimit nga evidence e të dënuarëve.

3.3.1. BAZA LIGJORE

Për të kuptuar zbatimin sa më të drejtë dhe sa më të qartë të institutit të faljes në përgjithësi si dhe amnistisë si pjesë e institutit të faljes , duhet që njëherë të kuptojmë bazat ligjore në të cilat mbështeten ato. Për dallim nga e drejta për falje e cila ishte nën kompetencë të presidentit të shtetit , amnistia e cila është fjalë greke që nënkupton *haresë*, ajo paraqet një aktë të sjell nga ana e parlamentit në formë të ligjit që do të thotë se është kompetencë e trupit legjislativ dhe kjo njejtë si falja është akt faljeje. Në RM për dallim nga shteti fqinjë I Republikës së Kosovës në të cilën amnistija nuk është kategori kushtetuese , këtu ajo përcaktohet me kushtetutë, respektivisht përcaktohet në pjesën në të cilën përshkruhen kompetencat e parlamentit si organ më I lartë legjislativ ku përveç tjerash një dër kompetencat e saj është edhe nxjerja e amnistisë në formë të ligjit, kjo çështje është përcaktuar në nenin 68 , p.l. I kushtetutës së RM-së në të cilën theksohet :”Kompetencë për dhënien e amnistisë është parlamenti I RM-së”.

Amnistia gjithashtu është e rregulluar edhe me Kodin Penale të RM-së në të cilën përcaktohet kuptimi I sajë dhe njëkohësiht përcaktohet edhe efekti I dhënies së sajë. Amnistia është akt I trupit legjislativ në formë të ligjit me të cilin rrethit të pacaktuar njerëzish, në mënyrë nominale u jepet liria nga ndjekja, liri të plotë ose të pjesshme prej kryerjes së dënimit, u ndryshohet dënimi I shqiptuar me dënim më të butë, u përcaktohet shlyerje të dënimit ose u hiqet pasoja e përcaktuar juridike të dënimit.³⁵

³⁵ KAMBOVSKI Vllado “ E drejta penale pjesa e përgjithshme”;(përkthim në gj.shqipe Afrim OSMANI dhe Ismail ZEJNELI), Shkup, fq.631

Në RM amnistia është e rregulluar me ligj të posaçshëm I emërtuar si Ligji për Amnisti, në të cilën përcaktohen definicioni, kushtet për zbatimin e sajë si dhe shumë çështje të tjera të cilat do të shqyrtohen në pjesën tjetër të kriterëve për zbatimin e të njejtës.

Duhet të theksohet se amnistia për dallim nga falja e cila jepet në formë të vendimit nga ana e Presidentit të shtetit, amnistia jepet në formë të aktit ligjor, që do të thotë si bazë ligjore për zbatimin e sajë është nxjerra e ligjit nga ana e parlamentit të shtetit, me të cilën përcaktohet kategoria e personave të cilët përfshihen me nxjerjen e këtij ligji si dhe veprat penale për të cilat nxiret vetë akti I amnistisë.

Amnistia në kuadër të institutit të faljes është e trajtuar edhe në shkencën juridiko-penale si pjesë e veçantë, në të cilën në mënyrë shkencore trajtohet kuptimi I sajë, përcaktimi I kompetencave për zbatimin e amnistisë si dhe specifikat e tjera për kategoritë e zbatimit duke dhënë të shembuj konkret për kuptimin sa më të qartë të të njejtës.

3.3.2. KRITERET

Në bazë të kuptimit të amnistisë si dhe kompetencave për nxjerjen e të njejtës të përcaktuar në KPM, në kushtetutën e RM-së si dhe në ligjin për Amnisti (*lex specialis*), pra amnistia nxiret në formë të ligjit dhe kështu paraqet akt të përgjithshëm kurse mënyra e caktimit të personave që u dedikohet është e ndryshme. Amnistia mund të jepet për të gjitha veprat penale që nënkupton edhe për ato vepra penale që ndiqen *ex officio* edhe ato vepra penale që ndiqen sipas padisë private. Një dër kriteret më kryesore të dhënies apo nxjerjes së aktit të amnistisë nga ana e parlamentit të shtetit është ajo se akti i amnistisë nxiret për personat e papërcaktuar emër për emër,pra ajo nxiret për disa grupe personash ose për disa lloje të veprave penale, kjo nënkupton se me aktin e amnistisë nga ndjekja penale nuk lirhoet personi i përcaktuar në emër por me këtë akt lirohen nga ndjekja ose u zbutet dënimi personave që kanë kryer një vepër penale duke e precizuar në aktin ligjorë se konkretisht për cilën vepër penale bëhet fjalë. Duhet theksuar se me amnisti mënyra e përcaktimit të llojeve të veprave penale ose të dënimeve është e ndryshme , ku me ligjin për amnisti mund të përcaktohet konkretisht vepra penale për të cilën jepet amnistia si psh. Mund të theksohet se amnistia jepet për veprat penale të parapara në nenin 132 të kodit penal. Ligji mund të përcaktoj gjithashtu edhe dënimin konkret që përfshihet me ligjin për

amnisti psh. Mund të theksohet për të gjithë personat të cilët janë të dënur me burgim deri në 2 (dy) vjet, ose të gjithë personat që janë dënuar me burgim 5 (pesë) vjet e më shumë u falet nga një vit. Gjithashtu me ligjin për manisti mund të përfshihen të dy kushtet repsektivisht edhe mund të përcaktohet se për cilët vepra penale vlen amnistia si, për cilët dënime vlen amnistia si dhe duke pasur parasyshë lartësinë e caktuar të dënimit.

Ligji me të cilën jepet manistia duhet të sillet gjithmonë për kategori të caktuar të veprave penale, kategori të caktuar të kryerësve ose përsona të dënuar, si dhe për kategori të caktuar të dënimeve, ku parlamenti nuk ka autorizim kushtetues të jep amnisti të pacaktuar që do të kishte të bëjë me gjithë veprat penale psh, ku do ta suspendoj zbatimin e KPM për kohë të caktuar sepse kjo do të thotë heqje apo abrogim të vet ligjit.³⁶ Në bazë të literaturës juridiko-penale ku trajtohet çështja e rregullimit të amnistisë theksohet se ligji për amnisti veprat penale për të cilat ka të bëjë duhet të jenë të përcaktuara sipas llojit , apo sipas rëdnësisë së dënimit të përcaktuar duke pasur parasyshë gjithmonë klauzulën positive (numërimi taksativ I vperave) apo klauzulën negative (veprat penale që përjashtohen nga ligji për amnisti)

Në ligjin për amnisti theksohet konkretisht se për cilët kategori personash mund të nxiret ky akt dhe atë në nenin 1 të këti ligji vjen në kjo vjenë në shprehje.

Më Ligjin për amnisti të vitit 2017 si ligji I fundit I amnistisë në nenin 1 të sajë,theksohet se me këtë ligj lirohen nga vuajtja e dënimit këto persona:

- Personat e gjykuar me aktgjykim të plotëfuqishqm me dënim me burgim për veprat penale të përcaktuar në Kodin penal të RM-së apo me ligje të tjera, të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë filluar me vuajtjen e dënimit me burgim në institucionet korektuese-përmisuese në RM.
- Personat e gjykuar me aktgjykim te plotëfuqishëm gjyqsorë me dënim me burgim për VP të përcaktuara me KP të ndonjë shteti tjetër, përderisa kryerësi është shtetas I RM-së dhe dënimin e vuan në RM në bazë të zbatimit të aktgjykimit të gjykatave ndërkombëtare apo gjykatave të shteteve të huaja.

³⁶ KAMBOVSKI Vllado “ Edrejta penale pjesa e përgjithshme”;(përkthim në gj.shqipe Afrim OSMANI dhe Ismail ZEJNELI), Shkup, fq.631

- Personat e gjykuar të cilët ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë filluar me vuajtjen e dënimit me burgim.

Në nenin 2 po të këtij ligji bëhet fjale për personat e gjykar me burgim dhe bëhet fjalë se në çfarë lartësie të dënimit janë dënuar ato dhe procesi për të cilën ato lirohen nga një pjesë e dënimit. Respektivisht në këtë nen theksohen se kryerësit e verpave penale të përcaktuar me nenin paraprak të këtij ligji pra me nenin 1 të cilëve u është shqiptuar pra dënimim me burgim mirëpo me afat më të shkurtër pra, me burgim deri në gjashtë(6) muaj burgim, të njejtit lirohen plotësisht nga vuajtja e dënimit të shqiptuar, kurse personat e tjerë të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji lirohen nga vuajtja e dënimit me burgim me 30% nga dënimi I përgjithshëm I përcaktuar me aktgjykim të plotëfuqishëm gjyqsorë.

Duhet të theksohet se me ligjin për amnisti të vitit 2017 janë përcaktuar edhe kategoritë e personave për të cilët nuk vlenë ky ligj, kjo çështje është ë rregulluar me nenin 3 dhe neni 4, në këto nene rregullohet e ashtuquajtura klauzula negative me të cilën rregullohen veprat të cilat nuk janë të përfshira me amnisti. Me ligj parashihet se amnistija nuk vlenë për personat e gjykar edhe atë sipas këtyre veprave penale:

- Dënim me burgim të përjetshëm (ky dënim është paraparë për veprat penale më të rëndë të përshkruara në KP.)
- Për vepër penale Vrasje nga neni 123 të KP (edhe atë veprat penale të vrasjes qoftë ajo vepër e vrasjes gjatë ushtrimit të dhunës në familje, vrasje me të cilën u shkatohet rrezik jete edhe personave të tjerë, vrasje të personave të mitur apo grave, vrasje të grave shtatzëne etj.)
- Për vepra penale kundër votimit dhe zgjedhjeve (neni 158-165) të KP (me të cilën përfshihen veprat penale që kanë të bëjnë me pengimin e mbajtjes së zgjedhjeve, thyerje e së drejtës të lirë votimit, keqpërdorimi i të drejtës së votës, shkatrimi I materialit zgjedhor, mashtrimi zgjedhor, keqpërdorimi i buxhetit gjatë kohës së zgjedhjeve, keqpërdorim I mjeteve për finansim të kampanjës zgjedhore etj.)
- Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinorë (nenet 186-191-a, 193, 193-a, 193-b dhe 194) nga KP në të cilën hynë; Përdhunimi, sulmi seksual ndaj fëmijëve që nuk I

kanë mbushur moshën 14 vjeçare, kyçerja e prostitucionit, prostitucioni me fëmijë, prodhim dhe distribuimi me material pornografike për fëmijë, etj.

- Veprat penale kundër shtetit (nenet 305-327) të KP edhe atë: pranimi I okupimit, Vrasja e përfaqësuesve më të lartë shtetërorë, dhunë ndaj përfaqësuesve më të lartë shtetërorë, Sabotimi, Spiunimi, Tregimi I sekretit shtetërorë, Shërbimi në ushtritë e kundërshtarëve, pjesmarja në ushtritë e huaja, etj.
- Veprat penale që kanë të bëjnë me shoqatat kriminale (nenet 305-327) të KP në të cilën bëjnë pjesë vecanërisht vepra të rënda penale dhe atë: Shoqërimi me organizata kriminale, Organizatat terroriste, terrorizmi, finansimi I terrorizmit dhe zgjërimi I materialit ksenofobik në rrugë të sistemeve kompjuterike.
- Vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, ku përveç veprave penale të shkaktuara nga luftrat përfshihen edhe veprat penale të tregtisë me njerëz, tregti me fëmijë etj. (403-418-a,418-b deri 422) të KP, këto vepra penale kanë të bëjnë me të drejtën ndërkombëtare penale si një e drejtë supernacionale , që nënkupton për veprat penale ndërkombëtare vlejné kushte të caktuara për përgjegjësisë penale që janë të pavarura nga sistemi juridik I shtetit përkatës. Ku si funksion I normave ndërkombëtare si një e drejtë supernacionale është mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut. Këto norma të së drejtës supernacionale të së drejtës ndërkombëtare penale janë rregulla të obligueshme për çdo shtet pamvarsisht asaj se këto rregulla shteti përkatës a I rregullon me të drejtën nacionale të sajë.

Me këtë ligjë të amnistisë nuk janë të përfshirë edhe personat të gjykuar me aktgjykim të plotëfuqishëm të cilëve deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji u është lëshuar urdhërare të për shkak të pakapshmërisë së tyre nga ana e organeve ligjore. Gjithashtu me amnisti nuk përfshihen edhe personat veprat e të cilëve bëjnë pjesë në ligjin për amnisti por të cilat janë kryer pas datës 20.09.2017. gjyqtari kompetent për ekzekutim të dënimit është I obliguar në afat prej tre ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji që me shkrim të njoftoj gjykatën që është kompetente për plotësimin e kushteve nga paragrafi 1 I këtij neni.

Me nenin 5 të ligjit për manistij rregullohet procedura e dhënies së amnistisë, respektivish me këtë nen përcaktohet organi që e zbaton procedurën dhe dhënine e vendimit për

amnisti. Procedura për personat të cilët ndodhen në vuajtje të dënimit në institucionet korektuese-përmisuese të RM-së zbatohet në mënyrë zyrtare nga ana e organeve korektuese-përmisuese, kurse procedura për zbatim të këtij ligji për personat e gjykuar të cilët nuk kanë filluar me vuajtje të dënimit me burgim zbatohet nga ana e gjykatës kompetente që e ka sjellë aktgjykimin në shkallë të parë në mënyrë zyrtare, kjo bëhet me kërkesë të prokurorit publik apo me kërkesë të vet personit të gjykar. Në pajtueshmëri me neni 5 të këtij ligji, venimi për amnisti duke u bazuar në normat e këtij ligji e sjellë gjykata kompetente e shkallës së parë e cila e ka sjellë aktgjykimin në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimi të kërkesës në gjykatë. Me ligjin për amnisti në këtë nen rregullohet edhe mënyra e ankimimit të këtij vendimi me të cilën zbatohet amnistija, ku ankesë mund të paraqes personi I gjykuar apo person tjetër në emër të personi të gjykuar dhe në të mirë të tij, ku ankesa mund të paraqitet në afat prej 24 orëve nga pranimi I vendimit. Me ankesën kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë vendos gjykata më e lartë në afat prej 48 orëve, ku duhet theksohet se ankesa e parashtruar që është e përcaktuar ne paragrafin 4 të këtij nenin nuk e shtynë zbatimin e vendim. Lidhur me procedurën vlenë të theksohet se me nenin 6 të këtij ligji përcaktohet se për zbatim të procedurs të lëtij ligji do të vlejné dispozitat e Ligjit për Prodeurë Penale, përderisa me dizpotitat e tij nuk rregullohet ndryshe.

Me nenin 7 të këtij ligji rregullohet koha e hyrjes në fuqi të Ligjit për Amnisti ku theksohet se hyrja në fuqi e këtij ligji bhëet ditën e 8 (tetë) nga publikimi në “Gazetën Zyrtare”. Duhet të theksohet se amnistia si akt ligjor vlen vetëm për ato vepra penale të kryera deri në ditën e xjerjes së sajë, përjashtim kanë rastet kur me vetë aktin e aminstisë është vendosur ndyshe.

3.4. DALLIMET NË MES FALJES, AMNISTISË DHE ABOLACIONIT

Me qëllim të aritjes së njohurive sa më të thukta me këtë punim shknekorë, do të tentojë të bëjë dallimin në mes faljes, amnistisë dhe dallimi I abolacionit si formë e falje, duket sqaruar dallimet në mes kuptimit apo nocionit të tyre si dhe kriteret e zbatimit të tyre.

Me **falje** pra si është cekur edhe në kapitujt më lartë nënkuptohet një vendim të Presidentit përmes së cilës personat e caktuar emër për emër lirohen nga ndjekja penale, lirohen plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësohet dënimi I shqiptuar me dënim më të butë

apo me dënim me kusht, që dmth se me aktin e faljes një person lirohet qoftë nga ndjekja penale qoftë nga vuajtja e dënimit, falja është një akt i cili nxiret në formë të vendimit nga presidenti i shtetit me të cilën personat e caktuar emër për emër lirohen pjesërisht ose plotësisht nga ndjekja penale apo ekzekutimi i dënimit, mund që dënimi i shqiptuar t'i zëvendësohet me dënim më të butë, dënim me kusht. Për dhënien e faljes duhet të zbatohet ligji për falje me të cilën është rregulluar në mënyrë të detajuar kuptimi dhe procedura për zbatimin e të njejtës.

Për të kuptuar në mënyrë sa më të qartë dallimin mes faljes dhe amnistisë vlenë të theksohet se për dallim nga e drejta për falje e cila ishte nën kompetencë të presidentit të shtetit, **amistia** paraqet një akt të sjellë nga ana e parlamentit në formë të ligjit që do të thotë se është kompetencë e trupit legjislativ, ku me amnisti mund të kuptojmë aktin e trupit legjislativ të nxjerë në formë të ligjit me të cilin rrethit të pacaktuar njerëzish, pra personave të pa caktuar emër për emër, në mënyrë nominale u jepet liri të plotë ose të pjesshme prej kryerjes së dënimit, liri nga ndjekja, u ndryshohet dënimi i shqiptuar me dënim më të butë, u përcaktohet shlyerje të dënimit ose u hiqet pasoja e përcaktuar juridike të dënimit, pra dallimi thelbësorë në mes amnistisë dhe faljes qëndron në atë se falja jepet në formë të vendimit nga ana e Presidentit të shtetit, kurse amnisti jepet në formë të ligjit i cili nxiret nga ana e kuvendit apo trupti legjislativ të shtetit. Shikuar nga aspekti i përmbajtjes dhe efektet në statusin e personave të dënuar falja dhe amnistia janë të njejtë ngase edhe me fajë edhe me amnisti personi mund të lirhoet nga ndjekja penale qoftë ajo plotësisht apo lirim i pjesshëm ose zëvendësim i dënimit me dënim më të butë. Mirëpo shikuar nga aspekti i vëllimit, falja është më e gjerë se amnistia pasi me faljen mund të vijmë deri te shuarja e një numri më të madhë të sanksioneve që rrjedhin nga veprat penale dhe për dallim nga amnisti, me falje mund të bëhet edhe zëvendësimi i dënimit me dënim me kushtë.

Sa i përket **abolacionit**, edhe ajo sikurse falja dhe amnistia shpjen në shuarjen e dënimit dhe me atë mund të nënkuptojmë formën më të gjërë të faljes ku kryerësit të veprës penale i jepet falja me anë të së cilës ai lirohet nga ndjekja penale, si karakteristikë e abolacionit është ajo se abolacioni jepet në të gjitha fazat e procedurës penale deri sa nuk është nxjerë aktgjykimi i plotëfuqishëm, që nënkuptojmë se në rastet kur jepet abolacioni procedura penale nuk mund të fillojë ndërsa, nëse ajo ka filluar atëherë e njejtë ndërpritet pamarë parasyshë se në cilën fazë ka

arritur ajo. Pra dallimi I faljes dhe amnisitsë me abolacioni është ajo se falja dhe amnisti jepeshin në të gjitha fazat e procedurës penale qoftë edhe nëse personi veç më është I dënuar apo është në vuajtje të dënimit, dënimi mund ti zbutet ose me falje edhe personi mund të lirohet me kusht, kurse abolacioni jepet në të gjitha fazat e procedurës penale derisa nuk është nxjerë aktgjykimi I forëms së prerë.

KAPITULLI IV

4.RASTI I AKTIT TË FALJES NGA ANA E PRESIDENTIT TË RM-SË NË VITIN 2016

Duke pasur parasyshë që në këtë punim masteri si çështje kryesore e studimit është rasti i ndodhur në RM me aktin e faljes së dhënë nga presidenti i shtetit, krejtë me qëllim të arritjes së njohurive sa më të thella dhe më burimore , në këtë kapitull do të analizohet rrjedha e asaj se si ka ardhur deri te dhënija e këtij akti, ndryshimet dhe plotësimet përkatëse ligjore, cilët persona janë falur, shfuqizimi i pjesshëm i faljes si dhe deri te tërheqja e plotë e faljes.

4.1. LIGJI PËR FALJE DHE NDRYSHIMET PËRKATËSE LIGJORE

Me qëllim të shpjegimit në mënyrë më të qartë të asaj se çfarë ka ndodhur me vendimet e presidentit të shtetit, do të mundohem që në mënyrë kronologjike të paraqes ligjin për falje që nga pamvarsimi I RM-së e deri te ndryshimet e fundit të tij. Me vetë faktin se falja është një e drejtë e shefit të shtetit e garantuar me kushtetutë ajo është e rregulluar me ligj të posaçëm si lex specialis. Ligji për falje pas pamvarsimit të shtetit për herë të parë është miratuar nga fundi i vitit 1993, ku mes tjerash në atë ligj është përcaktuar se Presidenti mund të falë një person të dënuar me kërkesë të tij ose “ex office” apo mund të falë një person të akuzuar por jo të dënuar , pra personin e akuzuar për të cilin nuk është marrë vendim gjyqsorë por ende ndodhet në zhvillim të procedurës , por e gjitha kjo mund të bëhet vetëm me kërkesë të Ministrisë së Drejtësis në mënyrë zyrtare. Me këtë ligj nuk është bërë asnjë dallim apo kufizim të asaj se cilat krime ka mundur t’i fale presidenti e cilat jo, gjithashtu mes tjerash ky ligj ka përmbajtur një nen (neni 11) në të ciliën është paraparë se Presidenti në raste të jashtëzakonshme kur është në pyetje interesi i shtetit të mund të fale ndonjë person apo grup personash pa mos rrespektuar procedurat paraprake të cilat kërkohen për faljet e rregullta.

Me ndryshimet e Ligjit për falje të vitit 2009 të cilat përmbajnë ndryshime thelbësore në atë se parashihet kufizimi I presidentit të shtetit ku janë paraparë disa kategori të veprave

penale të cilat ai nuk ka mundur të fale, siç janë veprat penale për mashtrimet elektorale dhe krimet e tjera kundër sistemit zgjedhor, veprat penale në lidhje me substancat narkotike (droga), veprat penale ndërkombëtare (gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, terrorizmi etj) si dhe veprat penale që kanë të bëjnë me krimet e abuzimit seksual të fëmijëve. Gjithashtu duhet të theksohet se neni 11 i ligji për falje të vitit 1993 me të cilën Presidenti I shtetit kishte të drejtë ekluzive kur është në pyetje interesi I shtetit me përjashtim të falë një ose më tepër persona të akuzuar por të pa gjykuar me aktgjykim të plotëfuqishëm gjyqsorë, u fshi tërësisht me ndryshimet e vitit 2009.

Pas krizës politike që doli në RM në periudhën kohore 2014-2015, e cila rezultoi me marrëveshjen e Përzahinos dhe më vonë erdhi deri të krijimi I Prokurorisë Speciale Publike (PSP), shumica e pushtetarëve tentonin të gjejnë zgjidhje ligjore në mënyrë që të arrihet deri te parandalimi i ndjekjes së tyre për dyshimin e krimeve të korrupsionit, dyshime deri te të cilat rrjedhën nga të ashtuquajtura “bomba” të opozitës maqedonase të marra nga përgjimet të cilat kishin filluar të hetohen nga PSP-ja.

Gjykata Kushtetuese e RM-së më 14 mars të vitit 2016 do të marrë një vendim me të cilën deklaroi se ndryshimet ligjore të ligjit për falje të vitit 2009 konsiderohen si jo kushtetuese dhe i anulon si të tilla. Duke u bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese disa ekspertë ligjorë pranë qeverisë dhe presidencës në këtë mënyrë mendonin se kanë gjetur zgjidhje ligjore që Presidenti I shtetit të mund të falte ndonjë krim e sidomos krimet e korrupsionit dhe mashtrimet zgjedhore të cilat ishin edhe lëndë hetimi nga PSP-ja, pa mos zbatuar procedurë paraprake të parashikuar me ligjin për falje duke u thirrur në nenin 11 të viti 1993, pasi kanë llogaritur se me vendimin e Gjykatës Kushtetuese është kthyer në fuqi ligji paraprak. Mirëpo ky veprim dhe kjo zgjidhje ligjore të cilën mendonin ekspertët se e kishin gjetur mbeti formalisht e pa mundur, sepse sipas teorisë kushtetuese gjykata kushtetuese ka rolin që të vlerësoj kushtetueshmërinë dhe ligjshmërinë e akteve ligjore dhe të anulojë ndryshimet e ligjeve kur konstaton se të njëjtat bien ndesh me kushtetutën, por nuk mund të kthejë në fuqi dispozitat e aktit ligjorë të më parshëm tërësisht apo pjesërisht, sepse kjo detyrë është vetëm e Parlamentit si organ legjislativ I cili mund të miratoj ligje, ndryshime dhe përsosime të ligjeve ekzistuese, kurse gjykata kushtetuese mund t’i anulojë ato vetëm nëse konstaton se të njëjtat janë kundërkushtetuese. Gjykata Kushtetuese me marrjen e këtij vendimi ka qenë e mendimit se me anë të shfuqizimit të

ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit për falje të v.2009 do të rikthehet në fuqi ligji I vitit 1993, mirëpo kjo çështje duke analizuar në mënyrë teorike është e pamundur sepse atë dispozitë të cilën e shfuqizon Gjykata Kushtetuese e njejta ngelet e vdekur deri sa parlamenti si organ legjitlativ nuk miraton ligj tjetër. Me këtë veprim Gjykata Kushtetuese do të gaboj duke menduar se me shfuqizim të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit për falje do ti hap rrugë presidentit të shtetit të fal duke u bazuar në ligjin e vitit 1993, ajo përkundrazi me këtë vendim e bllokoj në tërësi Presidentin për veprimet e mëtutjeshme sepse nga ligji I vitit 1993 nga gjithsej 17 nene, 1 nen është fshi kurse 10 të tjera janë shfuqizuar dhe janë plotësuar, kurse nenet e ngelura pra 6 nene ishin të papërshtatshme për të ndërmarë veprime për ngritje të procedurës për çdo lloj vepre penale. Në ato dispozitat e ngelura gjendet edhe një nen respektivisht neni 3 në të cilën theksohet se kur është në pyetje Abolimi . e njejta duhet të zhvillohet vetëm nga ana e Ministrisë së drejtësisë në mënyrë zyrtare “ex officio” , në këtë rastë me vetë shfuqizimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit për falje Presidenti I shtetit ngelet pa kompetencë për çështjen e faljes.

4.2. MARRJA E VENDIMIT PËR FALJE

Pas vendimit të marrë nga ana e gjykatës kushtetuese me anë të së cilës I anuloi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për falje, më 12 prill të 2016 presidenti I shtetit Gjorgje Ivanov do të deklarojë me anë të një kumtese zyrtare për shtyp se ka lëshuar një vendim me qëllim të pajtimit dhe për të ndaluar të gjitha procedurat ligjore që zhvillohen në mes politikanëve dhe partnerëve apo mbështetësit e tyre, ky vendim I cili nuk ka qenë I paralajmëruar më parë nënkuptonte faljen për 56 persona me 41 vendime të posaçme për falje të sjella për një ditë për personat të cilët ishin të akuzuar për krime të ndryshme e në veçanti për krime të korupsionit, krime të manipulimit zgjedhor, madje kishte edhe persona të falur por të pa akuzuar për ndonjë vepër penale. Në delkaratën e tij Presidenti Ivanov do të deklarojë se ai ishte duke vepruar për të mirën e vendit , për ta mbrojtur atë nga interesat dhe shërbimet e huaja dhe sipas tij e gjithë krzia politike në shtet është nxitur, ka filluar dhe po përdoret në interes të fuqive të huaja të cilat kanë për qëllim të shkatrojnë unitetin Maqedonas. Me vendimet e marra nga ana e presidentit të shtetit do të shkelet gjithëçka e dalur nga marrëveshja e Përzahinos, ku nga 330,000 votues të dyshimit në listën zgjedhore ekipet e terrenit do ti kontrollojn vetëm 89,000 , të gjitha vendimet e mara nga ministrat e emëruar nga rradhët e Social-demokratëve në qeverinë teknike janë

anuluar, puna e Prokurorisë speciale do të vihet në pikëpyetje sepse shumica e çështjeve të nisura nën mandatin e kësaj prokurorie do të ndërpriten.

Poblemi kryesorë i vendimit të përgjithshëm të Presindeit Ivanov për faljen e 57 personave me 41 vendime të posaçme qëndron në bazën juridike të tyre. Ky vendim i Presidentit paraqet një shkelje skandaloze në aspektin juridike sepse veprimet e tilla janë veprime kundërkushtetuese dhe kundërligjore për të cilat presidenti i shtetit bartë përgjegjësi juridiko-penale për veprat penale të parapara në Kodin Penal të RM-së edhe atë në nenet konkrete 353 dhe 369 KPRM-së (keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimeve si dhe shkelje të fshetësisë të procedurës). Për këto vendime të shefit të shtetit skandali juridik mund të shihet nga një sër problemesh të natyrës material dhe formale liudhur me zbatimin e institutit të faljes si dhe me vetë mënyrën se si ky institut do të zbatohet në këto vendime të presidentit, këto problem konsistojnë në atë se presidenti i shtetit në kumtesën e tij për publikun ai mes tjerash do të theksoj se “ka sjellur amnisti për të gjithë personat për të cilët është sjellur tani më aktgjykim të plotëfuqishëm”, ka sjellur “vendim me të cilin bëhet ndërprerja e përgjithshme e të gjitha procedurave mes politikanëve dhe bashkëpunëtorëve ose përkrahësve të tyre nga palët kundërshtarë” etj, në rradhë të parë presidentit që nga kumtesa e lëshuar i ngatëron kuptimin e vet institutit të faljes duke ngatëruar amnistinë nga falja apo abolimi ,sepse amnistia paraqet akt të përgjithshëm juridik të cilën e sjell Parlamenti si organë legjislativ dhe e njejta sillet në formë të ligjit, kurse falja jepet në mënyrë të veçantë në bazë të procedurës të përcaktuar me ligj për falje dhe për vepra konkrete penal edhe nënkupton që ndokush të falet pasi është gjykuar apo pasi ka kaluar një periudhë të caktuar në institucione korrektuese -përmirësuese, kurse abolimi është diçka tjetër sepse ajo do të thotë të lirohet personi nga djekja për veprën e kryer penale pa mos u gjykuar apo pa mos qenë veç më në vuajtje të dënimit që nënkupton se të abolohe personi ati t’i falet vepra penale dhe kjo paraqet formë më të rëndë të faljes. Këtë dallim në kuptim nuk do ta kontestoj as edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj me të cilën do ti anulojë ndryshimet dhe plotsimet e ligjit për falje ku në arsyetimin e atij vendimi në pikën 5 thekson: “falja lidhet me individualizmin e kryerësve të veprave penale , e jo me numrin e përgjithshëm të veprave penale që eliminohen nga falja , sepse përgjithësia është element i amnistisë dhe jo edhe i faljes”, ky fakt nuk është kontestues për Gjykatën Kushtetuese sepse amnistia është akt i

përgjithshëm kurse falja akt i veçantë, vendimet e marra nga ana e Kryetarit të shtetit elementin e veçantisë ka tentuar që ta mbulojë duke sjellë 41 vendime të veçanta, por procedura e sjelljes së atyre vendimeve dhe arsyetimi politik tregojnë qartë se bëhet fjalë për amnisti.

Përveç kuptimit të vetë institutit të faljes problematikë është edhe ajo se në cilin nen është bazuar vendimi I përgjithshëm apo më mirë thënë 41 vendimet e veçanta të shefit të shtetit, duke analizuar vendimet e presidentit si dhe nga ajo që është shpallur në Gazetën Zyrtare, këto vendime të gjitha thiren në të njejtën bazë juridike edhe atë në nënin 84 paragrafi 1 alineja 9 të Kushtetutës së RM-së, nenet 1 dhe 11 të Ligjit për falje të vitit 1993 në lidhje me nenin 114 KPRM. Nga kjo mund të kuptojmë se të gjitha vendimet janë të bazuara në nenin 11 dhe se bëhet fjalë për falje apo librim nga ndjekja penale pa procedurë paraprake (abolacion). Me këto vendime Presidenti vetë e ka shkelur nenin 11, pra nenin në të cilin ai thihet për të gjitha vendimet që ai I ka sjellë edhe pse ai nuk ka pasur të drejtë të thihet në këtë nen, ku neni 11 I Ligjit për falje të vitit 1993 thekson se: *“Presidenti i Republikës me përjashtim mund të fal edhe pa zhvillim të procedurës për falje të paraparë në këtë ligj kur kjo është në interes të Republikës, ose kur rrethanat e posaçme të cilat I rreferohen personit dhe veprës penale tregojnë që është e arsyeshme”*, nga ky nen mund të kuptojmë se aty thesohet se e gjithë kjo mund të bëhet “me përjashtim”, mirëpo e gjithë kjo situatë me faljen e 57 personave në të njejtën ditë duke u thirrur në këtë nen dhe se në të ardhmen në mënyrë të ngjajshme do të veprohet në raste të tjera nuk duket si përjashtim ashtu siç theksohet në këtë nen, kjo më tepër lenë përshtyjen e krijimit të një rregulle të re me të cilën do të ndikohet në rasten e faljes së krimeve të kryera nga personalitete udhëheqëse duke arsyetuar me të ashtuquajturën “interes shtetëror” me këtë krijohen rrethana të atilla që tentohet të arsyetohet diçka e cila në asnjë mënyrë nuk mund të arsyetohet. Në aspektin e pjesës formale të këtyre vendimeve të shefit të shtetit shihet qartë që këto vendime kanë mungesë formale sepse çdo vendim I sjellë duhet në mënyrë të qartë dhe koncize të theksohet se për cilën vepër penale është lëshuar vendimi I faljes, pasi vetë instituti I faljes karakterizohet me elementin e veçantisë dhe individualizimit, kurse te vendimet e Presidentit të shpallura në Gazetën Zyrtare të RM-së nuk është shprehur asnjë arsyetim apo shpjegim tjetër përskaj asaj se në teorinë e së drejtës penale theksohet se vendimet e presidentit duhet të jenë të arsyetuara dhe për këtë presidenti është I obliguar dhe domosdoshmërisht të sqaroj se për cilat

arsye personit të cakutar I jepet falja dhe duhet të potencojë se për çfarë dallohet ai nga personat e tjerë që nuk janë falur, me këtë mënyrë vjen deri te shmangia e akuzave për mungesë transparente apo për keqpërdorim të detyrës zyrtare, mirëpo vendimet e shefit të shtetit tregojnë për një akt arbitrariteti të tij në vend që ai të jetë një instrument i drejtësisë.

Duke analizuar rrjedhën e veprimeve të shefit të shtetit si dhe shkeljet të cilat janë bërë, dua të theksoj se këto vendime të presidentit që nga shpallja e tyre kanë qenë të pavlefshme apo nule, sepse me vetë faktin që u fshi neni 11 I Ligjit për falje të v.1993 me ndryshimet dhe plotësimet të ligjit për falje të v.2009 u pamundësua një arbitrariteti që e vendos Presidentin mbi pushtetin gjyqësor dhe krijohet ashtu lloj situatë kur nuk ka asnjë kontrollues me të cilën shefi i shtetit i pamundësohet keqpërdorim i të drejtës së faljes. Nga ana e Gjykatës Kushtetuese të cilët në vendimin e tyre për anulim të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për falje në asnjë pjesë të arsyetimit të tyre nuk ndalen në analizë të nenit 11, mirëpo ky nen përmendet në mendimin e katër gjyqtarëve të cilët nuk e kanë nënshkruar atë vendim të gjykatës Kushtetuese, por megjithatë nga arsyetimi i tyre vërehet se edhe ata janë në lajthim me atë se neni 11 kthehet në fuqi. Këtë çështje e spjegon profesori Shkariq ku sqaron se në aspektin teorik kjo çështje nuk është kështu, ku gjykata Kushtetuese nuk mund të ringjallë norma të anuluar më herët me ndryshim të ligjit. Profesoresha Besa Arifi në analizën e saj për Redaksinë Portalb të datën 15.12.2016 do të paraqes një vendim të më parshëm të Gjykatës Kushtetuese me një situatë të ngjajshme për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, ku ajo do të theksoj: "koincidencë interesante është fakti që Gjykata Kushtetuese në një vendim tjetër të sjellur jo para shumë kohe me numër 97/2011-0-0 të datës 29.02.2012, Gjykata Kushtetuese e hedh poshtë iniciativën për ngritje të procedurës për vlerësimin e Kushtetueshmërisë se nenin 6 paragrafi 1 dhe nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë. Në Arsyetimin e gjykatës mestjerash theksohet: "Në rastin konkret me iniciativën e ngritur në fakt kërkohet nga Gjykata Kushtetuese ti anulohet dispozitat e kontestuarat të Ligjit për ndryshim dhe plotësim dhe ti rrisjellë në fuqi dispozitat që kanë vlejtur më parë... të cilat kanë qenë pjesë e dispozitave kontestuese dhe janë fshirë. Duke pasur parasysh që në pajtim me nenin 110 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente të kryejë funksion ligjdhënës dhe të sjellë norma,

duke I risjellur në fuqi dispozitat të cilat tani më nuk janë në qarkullim juridik, e as që ka kompetenca procedural të vendos rreth iniciativës, pra ta vlerësojë bazën kushtetuese të dispozitave të fshira dhe në anën tjetër bazën kushtetuese të dispozitave me të cilat ato janë fshirë nga Ligji, e as arsyeshmërinë e këtyre zgjidhjeve ligjore, Gjykata vlerëson që në rastin konkret janë plotësuar kushtet nga neni 28 alinetë 1 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese për hedhjen poshtë të iniciativës.” Kjo tregon qartë që vetë Gjykata Kushtetuese me vendim të saj ka konstatuar se nuk është kompetente të rrisjellë në fuqi dispozita të cilat më nuk janë pjesë e rregullimit juridik, kur jemi te Ligji për falje kemi situatë identike ku anulohet Ligji për ndryshim dhe plotësim por pa u sqaruar që dispozitat e ndryshuara ose të fshira të ligjit të ndryshuar me ligjin që anulohet nuk mund të kthehen në fuqi.” Nga ky sqarim I profesoreshës Besa Arifi mund të kuptojmë se si Gjykata kushtetuese për situata të njejta ka vepruar në mënyra të ndryshme ngase në arsyetimin e vendimit të tyre nuk ka sqaruar se me anulimin e Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për falje dispozitat e ndryshuara apo të fshira nuk kthehen në fuqi sepse një kompetencë të till për ti kthyer në fuqi ka vetem Parlamenti si organ ligjvënës, nga kjo mund të konstatohet se me vendimin e vetë Gjykata Kushtetuese vërteton se baza juridike e 41 vendimeve të Presidentit për falje është e pa vlefshme apo nule dhe kjo nënkupton se edhe vetë vendimet janë të pavlefshme që nga sjellja e tyre.

Nga vendimet e publikuara në Gazetën Zyrtare të RM-së me numër 2097 janë shënuar të gjithë emrat e persoave që I ka falur kryetari, edhe atë: Menduh Thaçi, Bedredin Ibraimi, Irena Misheva, Ljupço Dimovski, Gordana Jankullovska, Mile Janakievski, Zhivko Pejovski, Martin Protuger, Kiril Bozhinovski, Ljupço Todorovski, Sasho Mijalkov, Nikola Gruevski, Trajko Trpevski, Miroslav Jovanovik, Toni Trajkovski, Goran Grujevski, Zhivko Lukovski, Zoran Zaev, Trajko Vlejkanovski, Zoran Verushevski, Ivica Ançevski, Petar Miloshevski, Filip Atanasov, Goranço Todev, Metush Shabani, Novica Stankovski, Koce Trajanovski, Vladimir Todorovik, Risto Novaçevski, Todor Mirçevski, Kiro Todorovski, Nadica Velevska, Munir Pepiç, Edmond Temelko, Kosto Mitrovski, Vladimir Talevski, Toni Jakimovski, Nikola Boshkovski, Valentina Simonovska, Gorgi Lazarevski, Sonja Verushevska, Branko Palifrov, Aneta Stançevska, Ismet Guri, Dejan Mitrovski- Urko, Kosta Krpaç, Vladislav Stajkoviç, Hristijan Panev, Bozhidar Jankovski, Branko

Crvenkovski, Svetlana Kostova, Haim Hakijin (nga Izraeli), Lile Stefanova, Fatime Fetaj, Gavril Bubevski dhe Zvonko Kostovski.

Nga të dhënat e fituara në bazë të listës së publikuar në Gazetën Zyrtare të RM-së mund të konstatojmë se : pjesa më e madhe e të falurivë është nga radhë e VMRO-DPMNE-së edhe atë nga kreu më i lartë i partisë,ku nga lista mund të vërejmë se përgjithësisht janë falur dy ish kryeministra, tre ministra, lider të partive , prokurorë, kyretar i Kuvendit, drejtorë, kyretarë komunash, si dhe dy shtetas të huaj.

Të falurit nga rradhët e VMRO-DPMNE-së : Mile Janakievski – 16 herë (ish ministër i Transport dhe lidhjeve),Gordana Jankullovska – 11 herë (ish ministresha e MPB-së),Sasho Mijallkov – 6 herë (ish drejtor i DSK-së),Nikolla Gruevski – 5 herë (ish kryeministër I RM-së),Martin Protugjer- 5 herë (ish shef I kabinetit të Kryeministrit),Kiril Bozhinovski – 4 herë (sekretar I përgjithshëm I Qeverisë),Goran Gruevski – 3 herë (kyreshefi I Drejtorisë së 5 në MPB),Trajko Veljanovski -1 herë (kryetar I Kuvendit të RM-së),Irena Misheva – 1 herë (kryetare e Këshillit të qytetit të Shkupit),Zhivko Pejkovski – 1 herë (drejtor i burgut të Idrizovës),Dejan Mitrovski (Urko)- 1 herë (shefi I sigurimit t ëish Kryeministrit Gruevski)

Të falurit nga rradhët e LSDM-së : Zoran Zaev – 2 herë (kryetar I LSDM-së dhe kryetarë I komunës së Strumicës),Zoran Verushevski – 2 herë (ish drejtor I kundër zbulimit),Lupço Todorovski – 2 herë (ish drejtor I Byrosë për siguri publike),Branko Crvenkpovski – 1 herë (ish president dhe ish kryeministër I RM-së),Branko Palifrov – 1 herë (zyrtarë I punësuar në Komunën e Strumivës)

Kryetarë të komunave të falur : Vladimir Talevski -1 herë (kryetar I komunës së Manastirit),Koce Trajanovski – 1 herë (kryetar I Qytetit të Shkupit),Edmond Temellko -1 herë (kyetar I Pustecit),Vladimir Todoroviq -1 herë (ish kryetar I komunës Qendër),Toni Trajkovski - 1 herë (kryetar I komunës Gazi Baba)

Shqiptarë të falur : Mendu Thaçi – 1 herë (lider I PDSH-së),Bedredin Ibrahimimi – 1 herë (anëtarë I KSHZ-së),Ismet Guri – 1 herë (ish zv. Drejtor I DAP),Mitush Shabani – 1 herë

Persona tjerë të falur: Bozhidar Jankovski -1 herë (bashkëshorti I Radmila Sheqerinskës, drejtor I “Dajners”),Zharko Llukovski -1 herë (drejtor I “T-Mobile”),Miroslav jovanoviq-1 herë (drejtor gjeneral i IT pranë Telekomit),Svetlana Kostova – 1 herë (gjykatëse në Gjykatën e lartë

administrative),Hristijan Panev -1 herë (pornar I mediave të afërta me pushteitn),Vlladisllav Stajkoviq -1 herë (udhëheqës i “Radio Maqedonija e Lirë”),Kosta Krpac – 1 herë (pronar I agencijonit Nepres),Kosta Mitrovski -1 herë (kryetar I Komisionit Komunal Zgjedhor në komunën Qendër),Munir Pepiq -1 herë (I punësuar në stacionin policor “Be-Ko”),Sonja Verushevska -1 herë (bashkëshortja e Zoran Verushevskit),Fatime Fetaji -1 herë(Prokurore në PSP),Lile Stevanova -1 herë (Porukore në PSP),Gavrill Bubevski -1 herë (Prokurorë në PSP),Haim Hakijni -1 herë (shetasi I Izralet që ishte pjesë e “bombave”)

Veprimi I presidentit të shtetit do të trazojë opinionin politik si vendor ashtu edhe atë ndërkombëtarë në shtet, ku vendimi I tij do të konsiderohet skandaloz dhe I papërgjegjshëm veprim I cili do të shkaktojë edhe reagime të shumta të ndërkombëtarëve dhe diplomatëve të akredituar në Maqedoni të cilët do të shprehin habi nga vendimi drastik I kreut të shtetit, edhe pse ato nga presidenti I shtetit do të kërkojnë sqarime shtesë për vendimet e marra, ato do të shprehin edhe shqetësimet e tyre, ku SHBA-ja dhe Britania e Madhe theksojnë se vendimi është shumë shqetësues për demokracinë e vendit. Nga ambasada e SHBA-ve do të deklarojnë: “Po kërkojmë detaje dhe sqarime të mëtejshme. Deklarata e presidentit gjithësesi ngre shqetësime serioze rreth angazhimit të Maqedonisë për mbisundimin e së drejtës”, kurse nga ambasada e Britanisë do të deklarojnë: “Deklarata e presidentit gjatë pasdites duhet të sqarohet. Për sa kohë që vendimi për të falur politikanë, vlen edhe për hetimet ndaj akuzave të paraqitura në materialet e përgjuara, kjo do të ishte shumë shqetësuese. Hetimi I plotë I këtyre akuzave dhe procesi I duhur ligjorë , janë elemente thelbësore nga Marrëveshja e Përzahinos. Si të tilla, ato janë të rëndësishme për ‘do zgjidhje reale të krizës politike”. Veç tjerash reagime kishte edhe nga vetë opinion politik vendor qoft nga partitë opozitare ashtu edhe nga partia shqiptare e kualicionit të pushtetit të cilët do të theksojnë se vendimi I Presidentit thellon krizën politike dhe I njejti duhet t’i tërheq vendimet e tija duke kërkuar edhe dorëheqjen e vetë presidenitit. Qytetarë të shumtë pas veprimit të presidentit do të dalin në protesta përpara Qvererisë protesta të cilëve do tu paraprijë lideri I opozitës maqedonase Zoran Zaev të ashtuquajtura protesta për luftën për një Maqedoni demokrati, sudnimin e së drejtës etj.

Si rrjedhje e faljeve të dhëna nga presidenti do të pasojë edhe kërkesa e të burgosurve të cilët do të kërkojnë nga presidenti Gjorgjē Ivanov t'i fal edhe ata. Kështu 1800 të burgosur në Idrizovë dhe në burgun e Shtipit kërkesat e tyre nëpërmjet avokatëve i kanë dorëzuar në kabinet të presidentit, dhe theksojnë se u është bërë padrejtësi dhe janë lënë në harresë sepse përderisa mundët të falet elita politike ka hapsirë të falen edhe ata, ata nuk kërkonin falje të plotë, por vetëm ulje të dënimeve prë 30 deri në 50%.

4.3. ANULIMI I PJESSHËM DHE TËRHEQJA E VENDIMIT TË FALJES

Faljet skandaloze të Presidentit të shtetit iu nënshturan regaimeve të shumta qofshin ato të opinionit politik vendor ashtu edhe atij ndërkombatrë dhe ishin arsye për organizimin e protestave masovike dhe të vazhdueshme nga ana e qytetarëve të RM-së sepse ato konsideronin një shkelje të rëndë dhe sabotim të punës së PSP-së dhe sundimit të së drejtës, pas një situate të tillë dhe si rezultat i këtyre zhvillimeve pushteti do të tëntoj për gjetjen e një zgjidhje për problemin e faljes presidenciale, parlamenti i RM-së me procedurë të përshepjtuar dhe pa debat më 19 maj 2016 me 63 vota për dhe në mungesë të deputetëve të opozitës (LSDM-së dhe PDSH-së) miratoi një dryshim tjetër të Ligjit për Falje të publikuar në "Gazetën Zyrtare" të RM-së me numër 20/93,12/09 dhe 99/16³⁷, në të cilën u shtua neni 11a ku theksohet se Presidenti i shtetit në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji për faljet e dhëna pa procedurë paraprake ai mund të njejta ti tërheq dhe për tërheqejn a tyre nuk është i detyrar që vendimet për tërheqje të faljeve ti arsyetojë, gjithashtu një mundësi për tërheqjen e faljeve të dhëna u parapa edhe për vetë personat e falur për të cilët është dhënë falja mund që deri te presidenti i shtetit të paraqesin kërkesë për anulim të vendimit për falje dhe presidenti i shtetit në bazë të kërkesës së tyre duhet të vendos për anulim të vendimit për falje në afat prej 30 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës. Pas ndryshimit të ligji për falje dhe pasë trysnisë së madhe të ndërkombëtare presidenti Ivanov në një deklaratë për media do të deklarojë së ka vendos që të

³⁷ ЗАКОН ЗА ПОМИЛУВАЊЕ („Службен весник на Република Македонија“ бр. 20/93, 12/09 и 99/16)

bëjë anulimin të pjesshëm të vendimit për falje ku do të tërheq faljen për 22 persona nga gjithësej 56 të falur paraprakisht dhe me këtë ai do të theksojë se jep porosinë se askush nuk është mbi ligjin dhe se secili do të japë përgjegjësi për veprat e tij ,përfshirë edhe politikanët, por megjithatë ai do të theksojë se vendimi i tij për falje ka mundur të jetë mënyra më e mirë për dalje nga kriza, kurse personat e tjerë për të cilët nuk është bërë anulimi I vendimit për falje kanë mundësi që në përputhshmëri me ndryshimet e ligjit për falje në afat të caktuar të paraqesin kërkesë për anulim të vendimit për falje³⁸.

Nga ky veprim I parlamentit me ndryshimin e Ligjit për Falje si dhe me anulimin e pjesshëm të vendimit për falje nga ana e presidentit të shtetit kuptojmë se paraqiten dy probleme thelbësore edhe atë: *së pari* ky ndryshim I ligjit nuk e kundërshton ekzistencën e nenit 11 dhe në këtë mënyrë faljet e dhëna i konsideron krejtësisht të rrëgullta dhe nuk llogariten si jo të rrëgullta që nga dhënija e tyre , sepse neni I pa ekiztuar neni 11 është përmirësuar me nenin 11a i cili jep mundësinë për tërheqjen e vendimeve për falje e cila në aspektin juridik paraqet një situatë të pamundur , pasi neni 11 që nga fillimi I marjes së vendimeve nuk ka ekzistuar dhe faljet kanë qenë të pa vlefshme që nga marja e tyre, dhe *së dyti* , shtate e këtillë krijon një praktikë shumë të rrezikshme pasi lenë hapësirë që falja e cila është konsideruar e rregullt dhe ligjore të tërhiqet një praktikë shumë e rrezikshme ,që nënkupton se çdo falje e dhënë në procedurë të rregullt mund të jetë edhe subjekt I tërheqjes pa mos pasur ndonjë arsytim nga Presidenti në vendimin për tërheqje të faljes së dhënë, që në aspektin juridik dhe në teorinë e së drejtës një gjë e tillë është e pamundur pasi falja e dhënë një herë nuk mund të revokot, ato duhet të jenë përfundimtare dhe të përvokueshme, në teorinë e së drejtës kjo është paraparë që me këtë mënyrë të parandalohet çdo lloj dhe formë e arbitraritetit.

Edhe akti I anulimit të pjesshëm të vendimeve për falje nga ana e presidentit do ti nënshtrohet reagimeve të shumta të opinionit politik vendor si partive shiqptare të pushtetit edhe të opozitës ashtu edhe të opozitës maqedonase, por një reëagim I njejtë nuk ka pasur nga ana e partisë maqedonsae në pushtet VMRO-DPMNE-së , e cila ka qenë e para që e ka

³⁸Shih: <http://pretsedatel.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-07-19-10-40-39/3821-obrakanjepomiluvanja.html?qh=YTo2OntpOjA7czoxMjoi0L7QtNC70YPQutCëlJtpOjE7czo00iLQt9CëlJtpOjI7czoyMDoi0L%2FQvtC80LjQu9GD0LLQsNGa0LUiO2k6MztzOjE30iLQvtC00LvRg9C60LAg0LfQsCl7aTo003M6Mzg6ltC+0LTQu9GD0LrQsCDQt9CëlNC%2F0L7QvNC40LvRg9Cy0LDRmtC1ljtpOjU7czoyNToi0LfQsCDQv9C+0LzQuNC70YPQstCë0ZrQtSI7fQ%3D%3D>

përshëndëtur vendimin e presidentit, reagime kishte edhe nga faktori ndërkombëtarë drejtuar presidentit me mesazhe të qarta dhe qëndrime të prera për anulim të të gjitha vendimeve për falje dhe miratim të një ligji të barabartë për të gjithë dhe t'i mundësohet Prokurorisë Speciale dhe ekiet e saja të bëjnë punën e tyre.

Me kërkesët të opozitës maqedonase deri te Kuvendi I RM-së do të paraqitet propozim për impiçmet të presidentit në lidhje me vendimet për abolim të mara nga ana e tij, ku kuvendi do të pranoj propozimin dhe me 52 vota pro dhe 33 vota kundër do të sjell vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e bazës së Propozimit për komfirmimin e përgjegjësisë së presidentit Gjorgje Ivanov për vendimin për abolim, komision ky I cili do të përbëhej prej 11 anëtarëve, kryetari I së cilës do të jetë Zoran Ilijoski nga rradhët e VMRO-DPMNE-së e cila do të ketë edhe pesë anëtarë të tjerë, dy anëtar do të jenë nga rradhët e BDI-së, dy nga rradhët e LSDM-së dhe një nga radha e PDSH-së. Komisioni për vlerësimin e bazës së Propozimit për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së presidentit të Republikës së Maqedonisë me gjashtë vota "për" dhe katër "kundër" vlerësoi se propozimi për impiçment i Ivanovit i parashtruar nga deputetët e opozitës, nuk ka bazë.

Edhe përkaj paraqitjeve të shumta të presidentit Ivanov për parashtrim të kërkesave për anulim të vendimeve për falje në bazë të ndryshimit të Ligjit për falje, kërkesa të tilla nuk pati dhe për këtë fakt presidenti Gjorgje Ivanov do të paraqes një deklaratë për shtyp më datë 06.05.2016 me të cilën do të theksoj se ka marë vendim për të tërhequr edhe 34 vendimet e ngelura për falje³⁹, me këtë ai do të theksoj se do ta shfrytësojë këtë mundësi ligjore me qëllim të arrihet një pajtim nacional dhe të kontriboj që të vjen deri te zgjidhja e krizës politike në vend.

Që nga pamvarsimi i RM-së nga gjithësej katër presidentë të drejtën e abolimit të paraparë me Ligjin për falje të vitit 1993 respektivisht në nenin 11 të këtij ligji e kanë shfrytëzuar edhe presidentët e më parshëm të RM-së, me qëllim që të kuptohet më mirë se cili president në çfarë mënyre e ka shfrytëzuar këtë të drejtë do të mundohem që t'a paraqes në mënyrë tabelare.

³⁹ <http://pretsedatel.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-09-03-11-41-54/3830-pismenaizjavapomiluvanja.html?qh=YT020ntpOjA7czoxMjoi0L7QtNC70YPQutCëlJtpOjE7czo00iLQt9CëlJtpOjI7czoyMDoi0L%2FQvtC80LjQu9GD0LLQsNGa0LUi02k6Mztz0jE30iLQvtC00LvRg9C60LAG0LfQsCI7aTo003M6Mzg6ItC+0LTQu9GD0LrQsCDQt9CêINC%2F0L7QvNC40LvRg9Cy0LDRmtC11jtpOjU7czoyNToi0LfQsCDQv9C+0LzQuNC70YPQstCê0ZrQtSI7fQ%3D%3D>

NR.	EMBRI DHE MBIEMRI	VITI I MANDATIT	VITI I SHFRYTËZIMIT TË ABOLACIONIT	NUMRI I PERSONAVE TË FALUR ME ANË TË ABOLACIONIT
1.	Kiro Gligorov	1991 - 1999	/	/
2.	Boris Trajkovski	1999 - 2004	2003	2
3.	Branko Crvenkovski	2004 - 2009	2008	6
4.	Gjorgje Ivanov	2009 -2019	2016	56

Tabela nr.1 Shfrytëzimi i abolacionit nga ana e ish Presidentëve të RM-së

Nga tabela e paraqitur më lartë (Tabela nr.1) mund të shihet qartë se nga gjithësej katër Presidentë të RM-së, aboliacionin e kanë shfrytëzuar tre Presidentë edhe atë për herë të parë e ka shfrytëzuar presidenti I dytë Boris Trajkovski në vitin 2003, me vendim të këtill ai e ka ndërprerë zhvillimin e procedurës për ndjekje penale kundër ish ministreshës për punë të bredëshme dhe funksionere e lartë në VMRO-DPMNE-së, Dosta Dimovska dhe ish kryeshefit të Drejtorisë së pestë të DSK-së Aleksandar Cvetkov , për rastin “Veshi I madh” të vitit 2001. Gjitashtu nga tabela vërejmë se presidenti Branko Crvenkovski plot pesë vite më vonë në vitin 2008 me aktin e abolacionit e ka falur dhe ka ndërprerë procedurën e më tejshme për ndjekje penale të kryetarit të atëhershëm të komunës së Strumicës (lideri aktual I LSDM-së) Zoran Zaev si dhe pesë bashkëpunëtorë të tij, për rastin e qendrës tregtare “ Global” në Strumic. Si president I tretë që ka shfrytëzuar të drejtën e abolimit në bazë të tabelës është Gjorgje Ivanov I cili me vendimin për abolim në vitin 2016 do të ndërpresë procedurën për ndjekje penale të 56 personave duke përfshirë funksionarë të lartë të institucioneve shtetore si ish kryeministër, ish ministra, sekretar shtetërorë, kryetar komunash, prokurorë, drejtorë etj. Për dallim prej 2 paraardhësve të tij vendimet e presidentit Gjorgji Ivanov nuk do të ngelen në fuqi në bazë të vlefshmërisë juridike që nga sjellja e tyre dhe të njejtat më vonë do të tërhiqen nga presidenti. Nga tabela mund të konstatojmë se nga gjithësej 4 presidentë të drejtën e abolimit nuk e ka shfrytëzuar vetëm presidenti I parë nga pamvarsimi I shtetit respektivisht presidenti Kiro Gligorov.

4.4. INTERVISTA

Duke pasur parasyshë që ky punim të posedojë më tepër burime dhe që të arrihet të njohurit sa më të qarta të situatës së përshkruar në vetë punimin, e kam pa të arsyeshme të realizoj një intervistë pyetje-përgjigje me ish Ministrin e Drejtsisë të RM-së z.Valdet Xhafer aktualisht drejtor i Byrosë për ekspertizë ligjore të RVM-së , duke krijuar përshtypjen se të dhënat të cilat mund t’I fitojmë gjatë kësaj interviste do të jenë me vlerë dhe do të mundësojnë të krijojmë njohuri të thukta me rastin e përshkruar në këtë punim masteri. Intervista është realizuar në periudhën kohore gjatë pregaditjes së punimin respektivisht më datë 04.03.2019.

Pyetja: Sa ka të drejtë presidneti që të fal personat që janë në procedure hetimore, në këtë rast a duhet propozimi I ministrisë së drejtësisë apo është në kompetencë direkte tëpresidentit të shtetit?

Përgjigje : kjo është çështje e lidhur me nenin 11 të Ligjit për falje të vitit 1993 I cili parashe abolacionin si koncept teje të ngushtë dhe si përjashtim në raste shumë specifike si diskrecion të institucionit të presidentit, dilema që ngritet rreth faktit se plotëfuqishmëria e këtij neni është e kontestueshme dhe kundrejt faktit se gjykata Kushtetuese I anuloi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për falje të vitit 2009 sidomos nëse merret parasyshë momentet dhe rrethanat në të cilat u soll një vendim I tillë jo adekuat mund të konstatojmë se kjo nuk është në përputhshmëri me kushtetutën pra duhet të merren parasyshë rrethanat e përgjithshme në vend dhe më pas të falen apo abolohehen personat që janë në procedurë hetimore ose parahetimore.

Pyetja: Si e vlerësoni vendimin e presidentit Ivanov për sjelljen e aktit të faljes, rastet e faljes së politikanëve?

Përgjigje: Edhe në kohën kur ish ministër I drejtsisë presidenti Ivanov bëri veprimin më skandaloz të mundshëm të tijin I cili nuk ishte I vetëm, solli një vendim për të aboluuar një numër të madh të personave të cilët mund të ishin të dënuar, një pjese e tyre vuanin dënimin një pjesë jo, dhe aso kohe në një periudhë tejet të vështirë në një periudhë të thellë të krizës politike e kam thënë se vendimi i të ashtuquajturit presidenti e ka thelluar edhe më tepër krizën politike dhe nuk I ka ndihmuar të njejtës, në ndërkoh që arsyetimi I presidentit për të njejtën ishte se ka

dashur që t'i ndihmoj daljes nga kriza e MK-së dhe prandaj ka menduar se me vendim të tillë për të aboluar të gjithë politikanët dhe bashkëpunëtorët e tyre në procedurë hetimore, duke përgshirë edhe udhëheqësit e opozitës dhe të pushteit të asaj kohe duke mos i specifikuar me emra dhe mbiemra dhe duke i përfshirë të gjithë këto persona Ai do të ndihmonte në qetësim të palëve, në pajtim të palëve të cilët aso kohe kishin ndasi të jashtëzakonshme dhe në normalizim të situatës politike e cila në atë periudhë ishte nga më të rrezikshmet që mund të ishin krijuar në MK që nga pamvarsia, dhe dua t'a citoj veten në dy-tre raste publike ku kam thënë se edhe pse ministri i drejtsisë nuk bën vlerësinim e kushtetueshmëris apo ligjshmërisë të disa vendimeve duke përfshi edhe vendimin e presidentiti por si ministër vlerësoj se bëhet fjalë për një vendim jo të duhur jo adekuat i cili në vend se të zgjidh krizën ajo e thellojë edhe më tepër, zgjidhje të krizës do të ndodh vetëm me zbatimin e plotë të marrëveshjes së Përshinos e cila u arrit në mes katër partive më të mëdha në vend , pas një krize të gjatë politike dhe pas plasimit të më tepër se 35 bomba të opozitës së atëhershme , marrëveshje kjo e cila ka mbështetjen e faktorit ndërkombëtar dhe e nënshkruar nga katër liderët e katër partive më të mëdha në vend , dhe këtu në rradhë të parë shumë persona nuk e kishin të qartë se bëhej falje për falje apo për abolim, dua që përsëri të theksoj se instituti i faljes në MK rregullohet me Ligjin për falje , ndërkoh që procedura e faljes është procedurë që inicohet me kërkesë të palës dhe ex officio nga ministri i drejtsisë i cili propozon emrat deri tek presidenti i cili mer vendimin, mirëpo abolacioni është koncept tjetër i cili buron nga neni 11 i ligjit për falje të vitit 1993 , dhe i njejti paraqet përjashtim nga procedura e rregullt por vetëm në rastë të ngushta kur paraqet interes për republikën dhe për rrethana të lidhura ngushtë të personit me veprën penale dëshmojnë se një vendim dhe veprim i tillë është i arsyeshëm , kurse amnistia është një instut tjetër i drejtsisë që sipas sistemit juridik të maqedonisë orgn kompetent për ta sjellë atë është parlamneti i MK-së i cili këtë e bën me ligj të posaçëm, pra këtu kemi tre kategori të veçanta të cilat në një far forme e kanë të njejtin efekt , të treja këto kategori kanë për qëllim që të falin personin i cili është i dënuar me vendim të plotëfuqishëm nga gjykata përkatëse.

Pyetja: A mund të na tregoni si qëndron bashkëpunimi në mes së Ministris së Drejtsisë dhe Presidnecës?

Përgjigje: Bashkëpunimi institucional në mes ministrit të drejtësisë dhe presidentit edhe në aspektin ligjor të parashikuar duhet të jetë tepër i afërt apo i ngushtë e sidomos kur është në shprehje procesi i faljes për arsye se këto dy institucione janë të vetmet të cilat e monitorojnë dhe e realizojnë njëkohësisht institutin e faljes dhe procesin e faljes, ministria e drejtësisë nga njëra anë është e lidhur me drejtorinë për ekzekutimin e sanksioneve ku vuajnë dënimin personat të cilët kërkojnë falje dhe nga ana tjetër nga gjykatat nga ku vijnë kërkesat e ndryshme nga personat e dënuar, gjykatat gjithashtu janë institucioni i cili me vendim të plotëfuqishëm dënon një person i cili ka shkelur ligjin, kjo është pjesa që e mbulon ministria e drejtësisë ku ministria e drejtësisë është e organizuar për procesin e faljes me sektorë të veçantë brenda saj dhe pastaj nga tjetër e medaljes është presidenti i shtetit i cili ka të drejtën ekskluzive sipas kushtetutës dhe ligjit që me vendim të tijin të jashtëzakonshëm të shfrytëzojë një të drejtë kushtetuese siç është falja, të vendos se cilët persona do t'i fal dhe cilët nuk do t'a marrin aminin e tij për falje dhe shikuar nga ky këndvështrim të dy institucionet në një formë e kanë të pamundur bashkëpunimin, në presidencë procesi i faljes kalon në dy shkallë është komisioni dhe pastaj vet presidenti, megjithë atë shikuar nga aspekti ligjor apo teorik duket gjithçka në rregull. Personalisht nga përvoja të cilën e kam kaluar si ministër i drejtësisë nuk mund të them se bashkëpunimi ka qenë i shkëlqyer apo i mirë me presidentin dhe kjo jo për shkak të mos zbatimit të ligjit apo të mos zbatimit të procedurës por për shkak të krejtësisht politike këtu kemi tejkaluar arsyen juridike dhe logjikën juridike dhe jemi ndeshur me probleme nga më të ndryshmet për inat për përplasje politike të cilat janë krijuar shumë më herët nëpërmjet institucioneve dhe në një shtet ku dallimet politike nuk duhet të ekzistojnë, falja si proces nuk do duhej të shkaktojte telashe administrativo-juridike apo politike nëpërmjet këtyre dy institucioneve, por përkundrazi ajo do të bashkonte këto dy institucione dhe është e rednësishme dhe vlen të theksohet se instituti i faljes është e vetmja rrugë që e lidh presidentin e shtetit me ministrin e drejtësisë dhe e kundërta, unë personalisht uroj që të tejkalohen në të ardhme ndashmërit politike dhe të respektohet aspekti profesionalo-juridik i procesit të faljes që edhe më tepër të thellohet bashkëpunimi në mes këtyre dy institucioneve të zhvillohet pa ndonjë pengesë apo problem ndryshe thënë bashkëpunimi në mes këtyre institucioneve për faljen të jetë i shkëlqyer se në fund të fundit vetëm falja si nocion si proces është e vetmja mundësi për bashkëpunim reciprok në mes këtyre institucioneve.

Si e vlerësoni të drejtën e faljes, jeni pro zbatimit të këtij instituti apo kontra, a mendoni se ky institut shërben në të mirë të personat e dënuar apo ka efekte negative te ata?

Meqë falja si proces është një mjet i jashtëzakonshëm juridik i cili shërben për t'i falur personat e dënuar për vepra penale duke i liruar nga dënimi i përcaktuar nga gjykata, meqë falja është e drejtë e presidentit që ka për qëllim përdorimin e një mjeti jot të rregullt për t'i shpërblyer sjelljet dhe si mjet i jashtëzakonshëm juridik falja e liron të dënuarin nga të gjitha dënimet që janë ngarkuar me vendim gjyqsorë përfundimtar e liron të njëjtin nga vuajtja e dënimit. Falja i ofron personit të dënuar rehabilitim të menjëhershëm mirpo e njëjta nuk ofron të drejtën për kompensim financiar ndaj të falurit, personi i falur nuk ndikon te personat e tjerë të dënuar apo të dëmtuar nga vepra penale, pra është e drejtë ekzkluzive që i drejtohet personalisht individit dhe duhet kuptuar se kërkesa për falje nuk e ndërpret ekzekutimin e dënimit, nga gjitha këto karakteristika që i përmendëm më herët dua të theksoj se nga përvoja që kemi kaluar rreth tre vite të gjysëm në ministri të drejtësis dhe rreth 1 vit të gjysëm si ministër i drejtësisë e kemi ndjekur procesin e faljes nga afër dhe në fund mund të konkludoj se definitivisht falja si mjet juridik është një proces i cili nuk duhet ofruar çdo të dënuari, mirëpo është pozitiv dhe është ndihmesë dhe dorë e zgjatur për të gjithë ato persona që kanë gabuar dhe një mundsi e mirë që nëpërmjet këtij instituti të mund të rehabilitoj dhe të kthjellë vetveten dhe në të ardhmen të mos e përsëris gabimin e njëjtë, ta shfrytëzoj faljen si motiv për ndryshimin e vetvetes. Andaj dua të vlerësoj se falja kryekput tek një pjesë e mirë e personave ka ndikuar pozitivisht për mos përsëritje të gabimeve që të mos jenë recidivist në jetën e tyre, por kjo nuk dmth se gjithë personat e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë në aspekt pozitiv, ka pasur edhe persona përkundër asaj se janë falur përsëri e kanë shkelur ligjin dhe ka kryer vepër penale. Në përgjithësi mund të theksoj se është çështje subjektive veprimi pas aktit të faljes por mund të them se është mjet i mirë për tu shfrytëzuar sidomos për personat të cilët për herë të parë kanë kryer vepër kanë gabuar për herë të parë.

KAPITULLI V

5. KONKUZIONI DHE PËRFUNDIME

Nga veprimi I presidneit të shtetit për faljen e 56 personave me 41 vendime të ndryshme, vendime të cilat që nga sjellja e tyre ishin të pa baza , të bazuara në një nen të pa qenë , dhe tërheqja e pjesshme e vendmieve të veta respektivisht të 22 vendimeve, duke pasuar më vonë edhe me tërheqjen e 34 vendimeve tjera, mund të konstatoj se I gjithë ky proces do të karakterizohet si një përpjekje e turpshme dhe e dështuar për të legalizuar korrupsionin, vendosjes së Presidentin mbi pushtetin gjyqësor duke dhënë një falje të përgjithshme për zyrtarët shtetërorë, politikanët dhe bashkëpunëtorët e tyre, në kundërshtim të kompetencave ligjore të parapara për kryetarin e shtetit, keqpërdorim I të drejtës së faljes dhe duke shkelur skajshmërisht parimet e sundimit të ligjit, sundimit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve. Kjo dërmarje e cila I përfshiu institucionet më të larta juridike të shtetit, duke përfshi Presidentit, Parlamentin dhe Gjykatën kushtetuese shpreh dështimin më serioz të sistemit ligjorë, dispozitave ligjore dhe institucioneve ligjore të vendit. Veprimet e presidentit të shtetit si dhe I gjithë procesi me vendimin e gjykatës kushtetuese, ndryshimet e ligjit të faljes mund të thuhet se në kohën e proceseve demokratike ato më tepër gjasojnë me një fuqi absolute të kohës së mesjetë se fuqis së monarkëve të cilën e karakterizon system I ngurt I drejtësisë dhe zbatim selektiv I të njetës. Mësimet të cilët duhet ti nxjerrim nga zbatimin I kësaj të drejte të kohës së sundimit të sulltanëve në perandorinë Osmane janë të një rëndësie të veçantë sepse kanë paraparë thelbin e institutit të faljes të zbatuar nga kreu I shtetit,që në atë kohë kanë paraparë këtë të drejtë si dhe nuk e kanë parë si pengesë për të kufizuar zbatimin e saj për disa krime të caktara e sidomos krahasimi I cili është bërë në mes krimeve të zyrtarëve shtetëror dhe qytetarëve të rëndomtë. E njejta nuk ka qenë praktikë në shtetitn tonë edhe në kohën e proceseve demokratike ku me ligjin e vitit 1993 nuk është paraparë ndonjë kufizim konkret por, përkudrazi shefit të shtetit i është mundësuar edhe falja pa procedurë paraprake duke përfshirë edhe faljen e krimeve të zyrtarëve shtetërorë.

Mund të konkludojmë se ekzistimi I institutit të faljes paraqet një verpim pozitiv të sistemit juridik të shtetit, mirëpo me kusht që ato të përdoren sipas ligjit dhe në harmoni me sundimin e ligjit dhe sundimin e së drejtës, duke mos ndikuar në pushtetin gjyqsorë. Do të ishte më e arsyeshme që në të ardhmen shefi I shteit të mos e zbatoj institutin e faljes si mënyrë dhe arsyetim për zgjidhjen e krizës politike siç bëri presidenti Ivanov. Kufizime i zbatimit të së drejtës së faljes me ligj për një kategori të veçantë të krimeve është veprimi më adekuat si dhe mundësia e shefit të shtetit për të falur pa procedurë paraprake dhe pa arsyetim të vendimin duhet që përfundimisht të mos jenë pjesë e legjislacionit dhe shefi I shtetit me detyrim të bëjë arsyetimin e vendimeve të ti. Shembullin e nxjerë nga legjislacioni I sheriatit dhe ligji penal osman lënë hapisrë për të mësuar nga rregulli dhe zbatimi I kësaj të drejtë sidomos do të kisha theksuar konceptin e sjelljes shtetërorë dhe përgjegjësia e sundimtarëve për mirëqenien e qytetarëve dhe për zhvillim të suksesshëm të shtetit, me qëllim që mos të vij deri te shpërfillja e interesit të përgjithshëm të qytetarëve dhe shfrytëzimi I privilegjeve të tyre pa mos pasur asnjë përgjegjësi për sjelljet e tyre të paligjshme.

BIBLIOGRAFIA

1. Akif Aydin "Türk Hukuk Tarihi", Il.bs., Istanbul, 2013
2. Hilmi Ismaili & Fatmir Sejdiu "*Historia e inistitucioneve juridike dhe shtetërore*", Prishtinë, 2009
3. Prof.Dr. Fetih GEDIKLI " *II. TURK HUKUK TARIHI KONGRESI BILDIRILERI CILT: II* " Uluslararası turk Hukuk Tarihi Kongresi 13-14 Mays 2016 Istanbul.
4. Yasar Yigit " *Islam ceza Hukuku – Hukumlarının Yurulugu*", Istanbul 2012
5. БУЖАРОВСКА – ЛАЖЕТИЌ, Гордана., *Новата улога на судот во текот на главната расправа според ЗКП 2010*, Здружение за кривично право и криминологија на Македонија, Скопје, 2011-2012.
6. БУЖАРОВСКА, Гордана, КАЛАЈЦИЕВ, Гордан, МИСОСКИ, Бобан, ИЛИЌ, Дивна, *Компаративно казнено процесно право*, Скопје, 2011.
7. ÇOLİÇ – SIJERÇİÇ, Hajrija, HALILIOVIQ, Haris., *E drejta e procedurës penale me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës*, Prishtinë, 2007.
8. ÇALLOVSKA, Neda., *Gjyqsori dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë*, Shkup, 2015.
9. HALILI, Ragip., *Penologjia*, Prishtinë, 2015.
10. HYSI, Vasilika., *Kriminologjia*, Tiranë, 2005.
11. ISLAMI, Halim, HOXHA, Artan, PANDA, Ilir., *Procedura penale - Komentar*, Tiranë, 2003.
12. КАЛАЈЦИЕВ, Гордан, БУЖАРОВСКА – ЛАЖЕТИЌ, Гордана., *Закон за кривична постапка*, Стручен осврт врз системот на казнената постапка воведен со законот за кривичната постапка од 2010 година, Скопје, 2011.
13. КАЛАЈЦИЕВ, Гордан, ВИТЛАРОВ, Тодор, ТРОМБЕВА, Мери, КРСТЕВСКА, Катерина., *Преуредување на претходната постапка во Република Македонија.*, Скопје, 2008.
14. KRAPAC, Davor, *Kazneno procesno pravo*, Botimi i katërt i plotësuar dhe i ndryshuar, Zagreb, 2010.
15. КОШЕВАЛИСКА., Олга, ИВАНОВА, Елена, "*Зајакнување на акузаторните елементи преку новиот концепт на главната расправа во кривичната постапка на Р*", Штип, 2014.
16. КАМБОВСКИ, Владо., *Кривичен законик*, Скопје, 2011.
17. LUARASI, Aleks., *Kodi penal me praktikë gjyqësore*, Tiranë, 1999.

18. МАТОВСКИ, Никола., *Казнено процесно право* – општ дел, Скопје, 2003.
19. МАТОВСКИ, Никола “ *Казнено процесно право* “ – посебен дел, Скопје, 2004.
20. МАТОВСКИ, Никола, БУЖАРОВСКА – ЛАЖЕТИЌ, Гордана, КАЛАЈЦИЕВ, Гордан, “*Казнено процесно право*” Скопје, 2009.
21. OSMANI, Afrim “*Fjalor terminologjik juridik*” Shkup, 2004.
22. OSMANI, Afrim., “*Kodi penal i republikës së maqedonisë*” Shkup, 2015.
23. PAVIĆIŠ, Berislav “*Transition of Criminal Procedures Systems*” Rijeka, 2004.
24. *Прирачник за законот за кривична постапка*, МВР на РМ, Биро за јавна безбедност, Центар за обука, Скопје, 2012.
25. ПРОЕВСКИ, Јован., *Кривичен Законик*, Скопје, 1998.
26. ПРОЕВСКИ, Јован, КРЦКОВСКИ, Миле., *Закон за кривична постапка - Коментар.*, Скопје, 1997.
27. САНИТИ, Ејуп, ZEJNELI, Ismail, “*E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë*”, Tetovë, 2007.
28. САНИТИ, Ејуп, MURATI, Rexhep., *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2013.
29. САНИТИ, Ејуп, MURATI, Rexhep, ELSHANI, Xhevdet., *Komentari i kodit të procedurës penale*, Prishtinë, 2014.
30. SALIHU, Ismet., *Edrejta penale – pjesa e përgjithshme*, Prishtinë, 2008.
31. SHEGANI, Altin., *E drejtë penale e krahasuar*, Tiranë, 2002.
32. ТРОМБЕВА, Мери., *Улогата и постапувањето на јавниот обвинител во предистражната постапка*, Здружение за кривично право и криминологија на Македонија, Скопје, 2011.
33. ТРАЈКОВСКА, Анита, *Улогата на јавниот обвинител и правосудната полиција во согласност со предлозите во новиот ЗКП*, Здружение за кривично право и криминологија на Македонија, Скопје, 2009.
34. ТУПАНЧЕСКИ, Никола., “*Кривичен законик – интегрален дел*”, Скопје, 2014 г.
35. ZEJNELI, Ismail., *E drejta penale – pjesa e posaçme*, Tetovë, 2007.

KUSHTETUTA DHE LIGJET

- Kushtetuta e RM-së
- Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtaree RM-së nr.124/97)
- Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtaree RM-së nr.150/10)
- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale (Gazeta zyrtareeRM-së nr. 2/06, 57/10, 170/13, 43/14).
- Ligji për kundravajtje (Gazeta zyrtaree RM-së nr. 62/06)
- Ligji për gjykatat (Gazeta zyrtaree RM-së nr.58/06)
- Ligji për falje i vitit 1993
- Ligji për falje (Gazeta zyrtare e RM-së me nr 20/93,12/09 dhe 99/16)
- Ligji për falje (Gazeta zyrtaree RM-së nr.20/93 dhe 12/90)
- Kodi penal i RM-së (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 37/1996; 80/1999; 4/2002; 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008; 114/09).
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RM-së me numër: 19/2016-0-1 të datës 16.03.2016

WEB FAQET E KLIKUARA

- www.pravda.gov.mk
- <http://www.pretsedatel.mk>
- <https://www.pravdiko.mk>
- <https://www.akademika.com.mk/>
- <http://www.praksis.com>
- www.akademik.mkb